# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6052
E enjte, 2 korrik 2020
çmimi 0.40 €


## Qeveria formon Këshillin e Ekspertëve për Dialogun me Serbinë

FAQE 5




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


GJERMANIA MERR PRESIDENCËN E BASHKIMIT EVROPIAN (BE) FAQE 4-5

# PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE, SHPRESAT TE GJERMANIA



Kosova shpreson që Gjermania do ta shtyjë përpara liberalizimin e vizave gjatë kohës sa do ta udhëheqë presidencën e Bashkimit Evropian. Përfaqësuesit politikë të Kosovës presin që qeveria gjermane gjatë periudhës gjashtëmujore (korrik-dhjetor) ta vendosë në agjendë heqjen e vizave për Kosovën. Ditë më parë edhe një grup deputetësh i Parlamentit Evropian i ka dërguar një letër kancelares gjermane, Angela Merkel, nga e cila ka kërkuar ta vendosë në agjendën e presidencës gjermane çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës

## 28 masa të reja për parandalimin e pandemisë Covid-19

QEVERIA E KOSOVËS DHE PËRFAQËSUESIT E SINDIKATAVE JANË PAJTUAR QË TA FORMOJNË GRUPIN PUNUES PËR TA PROCEDUAR NË KUVEND LIGJIN PËR PAGA

## Hoti: Me urgjencë do t'i trajtojmë vërejtjet e Kushtetueses për Ligjin për Paga



Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e sindikatave të sektorit publik, një ditë pasi Gjykata Kushtetuese ka hedhur poshtë Ligjin për Paga. Ai ka thënë se sa më shpejt do t'i trajtojnë vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese. "Unë do të vazhdoj të komunikoj me sindikalistët. Do të jem afër me ta dhe do ta mbikëqyr nga afër punën e grupit punues që do ta përgatisë Ligjin e Pagave për ta dërguar sa më parë në Kuvend", ka thënë Hoti

## OPINION

### KOSOVA NË UDHËKRYQ. A DO TË ARRIJNË LIDERËT INSTITUCIONALË DHE POLITIKË T'IA DALIN F. 11



Shkruan: Ramiz KELMENDI

## AKTUALE




### VAJZA E ISMAIL KADARESË ZGJEDHET ZËVENDËSPRESIDENTE E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË OKB-SË F. 2

### PROJEKTLIGJI I RI PËR QEVERINË PARASHEH TRE ZËVENDËSKRYEMINISTRA DHE 15 MINISTRI F. 5

## EKONOMI

### RRJETI I SHITËSVE ME PAKICË: SHPRESA E VETME MBETET FUNKSIONALIZIMI I PAKOS SË RIMËKËMBJES F. 8

### KRYEMINISTRI DHE GUVERNATORI BISEDOJNË PËR TËRHEQJEN E KURSIMEVE NGA TRUSTI F. 8

## SPORT

### DUKAGJINI, ENDE PA RËNË, E MENDON RIKTHIMIN NË SUPERLIGË F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Ahmeti: Mos të trembet askush nga kryeministri i parë shqiptar në Maqedoni

KUMANOVË, 1 KORRIK (ER) - Në promovimin e kandidatit për kryeministër të Republikës së Maqedonisë së Veriut që mban numrin 9 dhe që është nominuar nga Bashkimi Demokratik për Integrim, ka marrë pjesë edhe kryetari i kësaj partie, Ali Ahmeti. Ai në fjalën para të pranishmëve në Kumanovë ka thënë se janë vendosur në lëvizje jo vetëm vendi dhe rajoni, por edhe qendrat ndërkombëtare pasi, sipas tij, e drejta është në anën e tyre.
Ai ka thënë se kërkesa e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut për kryeministër shqiptar është e drejtë dhe legjitime. "Në vend se të gëzohen të tjerët, janë hidhëruar dhe zemëruar. Në vend se ta përshëndesin të tjerët, e përqeshin. Ne e dimë se kur shqetësohen të tjerët kanë një hall të madh, por ama të mos shqetësohen aq shumë, pasi me kryeministër shqiptar rritet lojaliteti i shqiptarëve ndaj shtetit. Me kryeministër shqiptar forcohen integriteti dhe sovraniteti i shtetit, ne nuk marrim hisen e tjetërkujt, pasi të huajën kurrë nuk e kemi dashur, por për hisen tonë gjak kemi derdhur" është shprehur Ahmeti.
Më tutje, Ahmeti ka thënë se brengoset nga politikanët e komunitetit maqedonas, por edhe nga udhëheqësit e partive politike shqiptare të cilët kanë reaguar për idenë e kryeministrit shqiptar të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ai ka thënë se askush nuk duhet të frikësohet nga kryeministri i parë shqiptar në Maqedoninë e Veriut. "Bashkëqytetarët tanë maqedonas më dëshpërojnë pasi menjëherë u trembën shumë nga ideja e kryeministrit shqiptar, duke thënë se nuk mund të jetë shqiptari kryeministër i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjysh, stërgjysh e katragjysh me tapi na kanë lënë këtë vend dhe bashkë me Diellin këtu jemi dhe askush nuk mund të na mohojë një të drejtë legjitime që vetë Zoti na e njeh. Si mund të zgjedhej kryetar i Parlamentit një shqiptar dhe pikërisht ata thoshin se nuk mund të bëhet, ministri i




Mbrojtjes shqiptar, i punëve të Brendshme shqiptar, kryetari i Gjykatës Supreme u bë shqiptar dhe asgjë nuk i ndodhi këtij vendi. Përkundrazi, proceset ecin para. Evropa është Evropë e diversiteteve", është shprehur Ahmeti.
Ai ka thënë se në mandatin e ri qeverisës do të ndodhë integrimi i Maqedonisë së Veriut në Bashkim Evropian (BE). "Në këtë mandat që vjen shohë shumë premtime, por në këtë mandat duhet një gjë të garantojë pala maqedonase, se ky vend do të anëtarësohet në Bashkimin Evropian (BE) dhe për ta anëtarësuar këtë vend në familjen e madhe evropiane, duhet të bëhen reforma të thella në drejtësi, të vendoset vetting i mirëfilltë, të luftoheb krimi dhe korrupsioni dhe këto punë mund t'i bëjë një kryeministër shqiptar", ka thënë Ahmeti.
Në fund të fjalimit të tij, Ali Ahmeti ka thënë se te BDI-ja sheh vlera që janë ndërtuar me vite të tëra. "Prandaj kërkohet mbështetja e shqiptarëve në tërësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe e komuniteteve të tjera, edhe pse nuk është thënë më herët, duke mos e mohuar se në krahë të luftës çlirimtare që e bëmë, fituan të drejtat e tyre edhe ata", është shprehur Ahmeti.

# Vajza e Ismail Kadaresë zgjedhet zëvendëspresidente e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së




TIRANË, 1 KORRIK (ER) - Besiana Kadare, vajza e shkrimtarit të njohur shqiptar Ismail Kadare, është zgjedhur zëvendëspresidente e OKB-së, duke përfaqësuar Shqipërinë dhe Evropën Lindore në sesionin e 75-të në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së.
Kadare shprehet se është privilegj dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme të ketë një post kaq të rëndësishëm, ndërkohë sqaron se Shqipëria do ta përfaqësojë Evropën Lindore në OKB, përfshirë Ballkanin, Rusinë, Ukrainën, Bjellorusinë, Armeninë etj.
"Jam krenare të njoftojë se Shqipëria është zgjedhur zëvendëspresidente e sesionit të 75 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Është nder i veçantë të shërbej si zëvendëspresidente e këtij sesioni historik dhe mezi pres të punoj me ambasadorin Volkan Bozkir, presidentin e sapozgjedhur të Asamblesë së Përgjithshme nga Turqia. Ky është një privilegj i madh dhe përgjegjësi e jashtëzakonshme për t'i shërbyer vendit tim në këtë post të rëndësishëm, me një vëmendje të madhe në arenën ndërkombëtare", ka shkruar Besiana Kadare në llogarinë e vet në "Facebook".

## Meta i gëzohet lajmit që Elez Biberaj emërohet drejtor i "Zërit të Amerikës"

TIRANË, 1 KORRIK (ER) - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se emërimi Elez Biberajt në postin e drejtorit të përgjithshëm në detyrë të "Zërit të Amerikës" është një lajm i madh dhe i gëzueshëm për të dhe të gjithë shqiptarët. "I pakompromis në mbrojtje të fjalës së lirë dhe standardeve më të mira të gazetarisë, me një karrierë brilante në këtë fushë, si analist i respektuar dhe drejtues i suksesshëm për një kohë të gjatë, z. Biberaj ka marrë një vlerësim të merituar. Z. Elez Biberaj është shembulli më i mirë se si një shqiptar në një sistem demokratik, falë talentit profesional dhe integritetit të lartë mund të shkëlqejë. Kush e mendonte 40 vjet më parë se i 'biri i diversantit' një ditë do t'i arrinte majat më të larta të medias së lirë", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Kosovës përgatitet për dialogun e Brukselit

# Qeveria formon Këshillin e Ekspertëve për Dialogun me Serbinë

Qeveria e Kosovës ka themeluar Këshillin e Ekspertëve për Dialogun me Serbinë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Detyrat e këtij Këshilli janë që të bëjë analiza specifike si dhe t'i këshillojë kryeministrin dhe qeverinë për çështjet e dialogut me Serbinë sipas temave që do të diskutohen në procesin e dialogut. Këshilli do të përgatisë raporte, dokumente për pozicionin e Kosovës, dokumente analitike dhe faktografike dhe dokumente të tjera sipas nevojës. Koordinatori Shtetëror për Dialog do ta udhëheqë punën e Këshillit



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e së mërkurës, ka miratuar vendimin për themelimin e Këshillit të Ekspertëve për Dialog me Serbinë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Detyrat e këtij Këshilli janë që të bëjë analiza specifike si dhe t'i këshillojë kryeministrin dhe qeverinë për çështjet e dialogut me Serbinë sipas temave që do të diskutohen në procesin e dialogut.

Zëvendëskryeministri Driton Selmanaj ka thënë se ky Këshill do të përgatisë raporte, dokumente për pozicionin e Kosovës, dokumente analitike e faktografike dhe dokumente të tjera sipas nevojës. "Propozojmë që të themelohet Këshilli i Ekspertëve për Dialogun me Serbinë, si zyrë e veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Këshilli i Ekspertëve bën analiza specifike dhe këshillon kryeministrin dhe qeverinë për çështje të dialogut me Serbinë, sipas temave që diskutohen në dialog", ka thënë Selmanaj në mbledhjen e qeverisë.

Ai ka treguar se Koordinatori Shtetëror për Dialog do ta udhëheqë punën e Këshillit dhe i njëjti është edhe këshilltar i kryeministrit. Sipas tij, koordinatori është koordinues me të gjitha palët në procesin e dialogut, në emër të kryeministrit. "Ky Këshill do të veprojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Përmes këtij vendimi do të caktohet edhe koordinatori shtetëror për dialog i cili do ta bëjë koordinimin e Këshillit, njëkohësisht edhe këshilltar i kryeministrit", ka thënë Selmanaj.

Më tej, zëvendëskryeministri Selmanaj ka treguar për detyrat e koordinatorit.

"Koordinatori është person kontaktues dhe koordinues në emër të kryeministrit me të gjitha palët sa i përket procesit të dialogut. Koordinatori, sipas nevojës, fton në Këshill ekspertë nga institucionet e ndryshme si dhe ekspertë të jashtëm", ka deklaruar Selmanaj.

Në këtë mbledhje të qeverisë, edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Ai ka thënë se, pavarësisht prej zhvillimeve që ndodhin, dialogu nuk ka alternativë për Kosovën. "Ne duhet të tregojmë përkushtim dhe gatishmëri si shtet që të hyjmë në këtë proces. Kosova është e përgatitur për këtë proces, është bërë një punë e madhe edhe në qeveritë e kaluara që tash është duke u sistemuar në secilën prej temave të mundshme të procesit të dialogut, i cili duhet të fillojë nga tema e dialogut që është njohja reciproke", ka thënë ai.

I pari i qeverisë ka vlerësuar se Kosova është duke u bërë gati për këtë proces të cilin do ta udhëheqë kryeministri. "Tani jemi duke punuar që të kompozojmë një delegacion, një ekip shtetëror që do ta përfaqësojë Kosovën në këtë proces, sigurisht i kryesuar nga kryeministri në bazë të kompetencave kushtetuese", ka deklaruar Hoti.

# Ministria e Jashtme pezullon vendimin për kthimin e disa diplomatëve të nënshkruar nga qeveria Kurti

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka pezulluar vendimin për kthimin e disa diplomatëve, të nënshkruar nga ish-qeveria e shkarkuar. "Nuk bëhet fjalë për anulim, por për pezullim të përkohshëm të vendimeve për kthim të disa diplomatëve, të nënshkruar nga ish-qeveria e shkarkuar", thuhet në njoftimin e MPJD-së.

Sipas kësaj ministrie, vendimi për pezullim nuk i përfshinë konsujt dhe as ambasadorët. "MPJD njofton opinionin se këto vendime do të shqyrtohen veç e veç brenda afatit shtatëditor dhe se vendimi përfundimtar do të merret pa asnjë paragjykim lidhur me vendimet e mëparshme apo pezullimin aktual të tyre", është bërë me dije në njoftimin e kësaj ministrie.




Ndaj këtij vendimi ka reaguar ish-ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca. Ai ka thënë se vendimi i së mërkurës i qeverisë Hoti, anulimi i vendimit për kthimin e konsujve të paligjshëm, tregon për orientimin thellësisht të gabueshëm politik të LDK-së. "Ky është koncesion kapital me shkelësit e ligjit dhe krimin e organizuar. Kosova ka vuajtur 20 vjet nga bandat e zhvatjes së institucioneve shtetërore, të cilët edhe misionet tona diplomatike dhe shërbimin tonë të jashtëm e kanë kthyer në shitblerje kriminale të pozitave publike", ka shkruar Konjufca në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se edhe vendimi i tij në atë kohë sa ishte ministër për kthimin e ambasadorëve politikë, të cilët kanë hyrë në mandatin e dytë, ka qenë i drejtë, i ligjshëm dhe i domosdoshëm. "Masa e të ngarkuarve politikë në misionet tona diplomatike ka shkuar në nivelin mbi 70 për qind. Ligji thotë se duhet të jenë në 50 për qind. Vendimi i sotshëm i qeverisë Hoti është argumenti më i mirë i mashtrimit të paskrupullt të elektoratit nga LDK-ja, duke ua premtuar në zgjedhje qytetarëve luftimin e krimit, por në të vërtetë duke ua sjell koalicionin e zhvatjes. Avdullah Hoti e ka bërë këtë veprim për shkak se është i shantazhueshëm nga PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma. Ai e di se pa këto kompromise me ta nuk mund të jetë kryeministër. Ama kjo tregon se qëllimi i tij suprem nuk është ndryshimi që populli i duhet, por përmbushja e ambicies së vet personale në kompromis me keqpërdoruesit tradicionalë të buxhetit të shtetit tonë. E ndytë dhe e pafalshme", ka thënë Konjufca.

Ai ka thënë se zgjedhjet e reja demokratike do të vijnë shumë shpejt sepse, sipas tij, qytetarët nuk do ta tolerojnë gjatë këtë mashtrim. "Prandaj këto vendime kriminale të qeverisë Hoti do të ndërpriten sapo të mbahen zgjedhjet që janë afër", ka deklaruar ish-ministri Konjufca.

GJERMANIA MERR PRESIDENCËN E BASHKIMIT EVROPIAN (BE)

# PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE,



Kosova shpreson që Gjermania do ta shtyjë përpara liberalizimin e vizave gjatë kohës sa do ta udhëheqë presidencën e Bashkimit Evropian. Përfaqësuesit politikë të Kosovës presin që qeveria gjermane gjatë periudhës gjashtëmujore (korrik-dhjetor) ta vendosë në agjendë heqjen e vizave për Kosovën. Ditë më parë edhe një grup deputetësh të Parlamentit Evropian i kanë dërguar një letër kancelares gjermane, Angela Merkel, nga e cila kërkojnë ta vendosë në agjendën e presidencës gjermane çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 1 KORRIK - Gjermania të mërkurën ka marrë përsipër presidencën gjashtëmujore të Bashkimit Evropian. Shumë vende anëtare të BE-së, por edhe vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE, e presin me padurim fillimin e presidencës gjermane të Bashkimit Evropian të udhëhequr nga Angela Merkel. Në këtë drejtim edhe Kosova i ka pritjet e veta.

Udhëheqësit e Kosovës shpresojnë se Gjermania do ta shtyjë përpara liberalizimin e vizave gjatë kohës sa do ta udhëheqë presidencën e Bashkimit Evropian. Ata kanë vlerësuar se presidenca gjermane do të sjellë një momentum të ri në çështjen e vonuar të liberalizimit të vizave për popullin e Kosovës

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter", ka uruar Gjermaninë për marrjen e kryesimit të presidencës së BE-së duke thënë se me Berlinin në timon, qytetarët e Kosovës do ta kenë mundësinë të udhëtojnë pa viza në Evropë. "Presidenca e Gjermanisë sjell një momentum të ri në çështjen e vonuar të liberalizimit të vizave për popullin e Kosovës. Ne jemi optimistë se me Gjermaninë në timon, njerëzit tanë përfundimisht do ta kenë mundësinë të lëvizin lirshëm në Evropë. Ne kemi shpresë që Gjermania do ta ruajë besueshmërinë e BE-së", ka shkruar Osmani

Edhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka kërkuar nga qeveria gjermane që gjatë periudhës gjashtëmujore ta vendosë në agjendë heqjen e vizave për Kosovën. "Gjermania po e merr presidencën e radhës së BE-së, në një kohë shumë sfiduese për shëndetin dhe ekonominë e Evropës. I jemi shumë mirënjohës Qeverisë gjermane për angazhimin e vazhdueshëm për zgjerimin e BE-së, duke i afruar vendet e Ballkanit Perëndimor dhe presim që gjatë kësaj kohe të hiqet edhe regjimi i vizave për qytetarët e Kosovës", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kurse ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë se presidenca gjermane shënon çaste kthese dhe definimi edhe për proceset e lidhura me Kosovën. "Është një moment kthese e definimi, me shpresa të rikthyera te qytetarët tanë, se gjatë presidencës gjermane me Bashkimin Evropian do të mbyllet suksesshëm lëvizja e lirë për Kosovën", ka deklaruar ajo.

Edhe ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se shpreson se gjatë udhëheqjes së presidencës së Këshillit të Bashkimit Evropian (BE) nga Gjermania do të ndodhë liberalizimi i vizave. Ai

# SHPRESAT TE GJERMANIA



ka thënë se drejtimi i presidencës së BE-së nga Gjermania është lajm i mirë për Kosovën. "Që sot Gjermania kryeson Presidencën e Këshillit të BE-së për gjashtë muajt e ardhshëm. Shteti gjerman me konsistencë ka mbështetur Kosovën drejt pavarësisë dhe shtetndërtimit, prandaj kryesimi i BE-së nga një aleat si Gjermania, përbën lajm të mirë për qytetarët e Kosovës. Kancelarja Merkel, si askush tjetër në BE, i kupton nevojat e Kosovës që janë ndrydhur për një kohë të gjatë si pasojë e politikave të ngadalta të Bashkimit Evropian" ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook", duke u shprehur i bindur se Gjermani do ta shtyjë përpara këtë çështje. "Nuk kam dyshim që përgjatë mandatit gjashtëmujor të Gjermanisë në krye të BE-së, një energji e re do ta përfundojë procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës dhe do t'i çojë përpara proceset integruese të Kosovës në organizatat dhe institucionet e Bashkimit Evropian", ka shkruar Haradinaj.

### Eurodeputët i shkruajnë Merkelit për Kosovën

Një grup deputetësh të Parlamentit Evropian, dy ditë më parë, i kanë dërguar një letër kancelares gjermane Angela Merkel, nga e cila kanë kërkuar që të futet në agjendën e presidencës gjermane të Këshillit Evropian çështja e liberalizimit të vizave për kosovarët. Në letrën e publikuar në "Twitter" nga eurodeputeti Ilhan Kyuchyuk, theksohet se kriteret nga Kosova janë përmbushur dy vjet më parë, ndërsa liberalizimi vijon që të mbetet peng. "Ata i kanë bërë detyrat e shtëpisë. Tani është radha jonë që ta mbajmë premtimin tonë. Ne po humbim besueshmërinë tonë, kur një vend i tretë bën atë që ne i kërkojmë, por ai nuk merr avantazhet që ia premtojmë. Si mund t'u kërkojmë reforma të tjera vendeve të fqinjësisë sonë, kur ato nuk mund të jenë të sigurta që mund të marrin gjë nga puna e tyre?", është thënë në letër.

Këtë nismë të deputetëve të Parlamentit Evropian e ka mirëpritur i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell. "Më në fund, ky është një lajm i mirëpritur edhe nëse ka si qëllim vetëm disa biznese. Përqendrimi i ShBA-së në normalizimin ekonomik ka motivuar evropianët të ndërmarrin veprime. Ne jemi të lumtur t'i shohim ata duke marrë udhëheqjen", ka shkruar Grenelli në rrjetin social "Twitter".

Kjo nuk është hera e parë që Grenelli flet për nevojën e liberalizimit të vizave për Kosovën nga Bashkimi Evropian. Më 20 qershor, gjatë një shkëmbimi të mesazheve në "Twitter" me raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon, ai pati kërkuar që ajo të mos e kritikojë administratën amerikane për çdo gjë, por të koncentrohet në liberalizimin e vizave. "Viola, në vend se të kritikoni çdo gjë që bën administrata Trump për të ndihmuar në normalizimin ekonomik në mes të Kosovës dhe Serbisë, pse nuk koncentrohesh vetëm në një gjë që duhet ta bësh: liberalizimin e vizave për Kosovën. Jeni ankuar për të tjerët për më shumë se 20 vjet. Bëni pjesën tuaj", kishte shkruar Grenelli.

Kosova është i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që ende nuk e gëzon të drejtën e lirisë së lëvizjes në Zonën Shengen, ndonëse vetë Komisioni Evropian e ka konfirmuar tashmë disa herë që Kosova i ka plotësuar kriteret për liberalizim.

Pas Gjermanisë, radhën do ta kenë Portugalia dhe Sllovenia.

Shumë vende anëtare të BE-së mirëpresin presidencën gjermane të BE-së të udhëhequr nga Angela Merkel, e cila insiston në ruajtjen e tregut evropian, integritetin politik dhe, mbi të gjitha, solidaritetin në një kohë krize shëndetësore dhe ekonomike. Merkeli ka thënë se tejkalimi i pandemisë së koronavirusit është një përparësi kryesore për presidencën e BE-së. Ajo tashmë ka përgatitur një plan të rimëkëmbjes ekonomike, për ta ndihmuar BE-në të përballet me pasojat pandemisë së koronavirusit.

# Projektligji i ri për qeverinë parasheh tre zëvendëskryeministra dhe 15 ministri

**Prishtinë, 1 korrik (ER)** - Zëvendëskryeministri i parë, Besnik Tahiri, ka prezantuar të mërkurën Projektligjin për qeverinë, në të cilin parashihen të jenë tre zëvendëskryeministra, 15 ministri, dy ministri në diskrecion të mandatarit, rreth 40 zëvendësministra, si dhe rreth 250 këshilltarë politikë. Tahiri ka thënë se ky projektligj do të sjellë organizim dhe funksionim më të mirë të qeverisë. "Projektligji parasheh tre zëvendëskryeministra, 15 ministri, dy ministri në diskrecion të mandatarit. Rreth 40 zëvendësministra, rreth 250 këshilltarë politikë dhe nënpunës të kabineteve. Nuk ka ministra pa portofol. Ndalohet krijimi i trupave shtesë me funksione paralele", ka thënë Tahiri para mediave.



Në këtë projektligj janë paraparë edhe kufizimet e qeverisë në dorëheqje. Po në këtë projektligj trajtohet edhe parandalimi i konfliktit të interesit, ku anëtarët e qeverisë dhe zëvendësministrat nuk mund të ushtrojnë funksion tjetër publik përveç kur ai ushtrohet sipas detyrës zyrtare. Po ashtu, nuk mund të ushtrojnë asnjë funksion në pushtetin lokal dhe nuk mund të mbajnë asnjë marrëdhënie tjetër të punës në sektorin privat.

Tahiri gjatë prezantimit të Projektligjit për qeverinë ka folur edhe sa i përket ligjit për paga. "Tek ligji i pagave jam i shokuar me vendimin. Nuk po e komentoj vendimin e gjykatës, por mua më duhet ta trajtoj ligjin që e kemi bërë. Nuk ka sindikatë që nuk është diskutuar për këtë ligj. Është një padrejtësi shumë e madhe për një numër të njerëzve. Këtë ligj kjo qeveri do ta marrë me prioritetin më të madh. Do të bëjë çmos ta dërgoj në Kuvend këtë vit", ka thënë Tahiri.

## LV-ja e dërgon në Kushtetuese presidentin Thaçi

PRISHTINË, 1 KORRIK - Lëvizja Vetëvendosje ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për, siç thuhet, "vlerësimin e veprimeve antikushtetuese të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, në rastin e nxitjes, bindjes dhe detyrimit të deputetit, Haxhi Shala, për ta ndryshuar qëndrimin për votën ndaj qeverisë".
Kërkesa është dorëzuar nga grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje. "Jashtë autorizimeve e në cenim të rëndë të vlerave, parimeve kushtetuese e demokratike, të ndarjes së pushteteve e ndërhyrje në kompetencat e Kuvendit, presidenti ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës. Ai në mënyrë të drejtpërdrejtë ka ndikuar që deputeti Shala ta ndryshojë qëndrimin dhe votën në seancën e jashtëzakonshme plenare të Kuvendit të Republikës të datës 3 qershor", thuhet në njoftimin e Vetëvendosjes.
Vota e deputetit të Nismës Socialdemokrate, Haxhi Shala, u kontestua në ditën që u votua qeveria e drejtuar nga Avdullah Hoti. Shala nxiti reagime të shumta, pasi vetëm pak minuta para se të votohej qeveria, mori fjalën në Kuvend dhe tha se kishte ndërruar mendje sa i takon votimit të qeverisë. Këtë tha se e bëri pasi i kishin shkuar në shtëpi presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj.
Vetë presidenti Thaçi e pranoi se kishte pasur takim me deputetin Haxhi Shala. Por, veprimin e tij presidenti e cilësoi vetëm si "këshillim".




# Vazhdon edhe për katër vjet projekti i UNDP-së për luftimin e korrupsionit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 KORRIK - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka njoftuar për fillimin e fazës së tretë të projektit Mbështetje Përpjekjeve Kundër-korrupsionit në Kosovë (SAEK III) 2020-2024, i financuar nga qeveria e Zvicrës (SDC) dhe e Suedisë (SIDA).
Në ceremoninë virtuale të nënshkrimit, përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së, Maria Suokko, ka thënë se përpjekjet e përbashkëta për ta luftuar korrupsionin janë veçanërisht të rëndësishme në këtë kohë të pandemisë globale Covid-19 kur autoritetet përballen me një krizë që nuk është vetëm shëndetësore, por edhe zhvillimore komplekse që ka prekur të gjitha fushat e jetës, përfshirë edhe qeverisjen. "Tani, më shumë se kurrë, është e rëndësishme që fondet publike të përdoren në mënyrë efikase dhe transparente për ata që kanë më shumë nevojë", ka thënë Suokko.
Ambasadori i Zvicrës, Jean-Hubert Lebet dhe ambasadorja e Suedisë, Karin Hernmarck Ahliny, në deklaratën e tyre të përbashkët theksuan: "Ne jemi të bindur që qytetarët e Kosovës meritojnë një të ardhme më të mirë, ku askush nuk është mbi ligjin. Kjo është arsyeja pse ne duam t'i ndihmojmë më tej institucionet kryesore në Kosovë në luftën e tyre kundër korrupsionit dhe rikuperimin e pasurive të vjedhura. Instrumentet kryesore janë të vendosura, por pas shumë vitesh premtime, mungesa e mbështetjes politike vazhdon t'i pengojë përpjekjet për ta luftuar korrupsionin. Ne presim vendosmëri më të fortë dhe rezultate më të prekshme".



Fazat e mëparshme të SAEK I (2012-2016) dhe SAEK II (2016-2020) u siguruan institucioneve të Kosovës mbështetje për hartimin e legjislacionit dhe politikave për parandalimin e korrupsionit, udhëzime për gjykata për dënime në rastet e korrupsionit, deklaratave të pasurisë dhe të të ardhurave të zyrtarëve publikë, financimin e partive politike dhe ndalimin e pastrimit të parave. Rritja e kapaciteteve të Agjencisë Kundër Korrupsionit rezultoi në 89 dënime, ndërsa platforma për raportimin e korrupsionit kallxo.com ka rezultuar me mbi 50 arrestime dhe aktakuza kundër zyrtarëve të lartë publikë. Projekti certifikoi më shumë se 40 ekzaminues të mashtrimeve që punojnë në organet hetimore që merren me raste të ndërlikuara të korrupsionit dhe krimit financiar.
Deri më tani SAEK i ka siguruar Kosovës një gamë të gjerë mjetesh elektronike për anti-korrupsion, duke përfshirë sistemin online të deklarimit të aseteve dhe të të ardhurave të zyrtarëve të lartë publikë; një sistem të menaxhimit të çështjeve për hetime paraprake të korrupsionit; një mjet online për prokurorinë për hetimin e të dhënave financiare të taksave dhe doganave të objektivave të korrupsionit dhe krimit financiar; Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP-sat) dhe bazat e të dhënave për rikuperimin e pasurive për t'i gjurmuar pasuritë personale dhe të korporatave.
Përpjekjet e SAEK-ut kanë rezultuar në atë që Kosova tani të ketë ekspertizë të brendshme për hetimin e krimit financiar, përdorimin e rregullt të mjeteve elektronike anti-korrupsion, posaçërisht të dizajnuara dhe bashkëpunim të fuqishëm ndërinstitucional, ku të gjitha këto janë themel për një sistem efikas anti-korrupsion. Duke u mbështetur në këto rezultate, SAEK III synon ta forcojë më tej transparencën dhe llogaridhënien, duke u përqendruar në rikuperimin e aseteve të vjedhura të fshehura.

## OSBE-ja, partnere e Ministrisë së Drejtësisë për mbështetjen e zbatimit të reformave

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka pritur të mërkurën në takim shefin e misionit të OSBE-së, ambasadorin Jan Braathu.
Ministri Selimi fillimisht ka falënderuar Braathun për përkrahjen e ofruar ndaj Ministrisë së Drejtësisë, njëherësh e ka informuar me prioritetet e mandatit të tij, përfshirë reformën në drejtësi, luftën kundër korrupsionit si dhe forcimin e shtetit ligjor.
Duke folur për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve, ministri Selimi ka vlerësuar gatishmërinë dhe përkrahjen e misionit të OSBE-së, i cili mbetet partner i rëndësishëm për Ministrinë e Drejtësisë, veçanërisht në sferën e sundimit të ligjit dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Nga ana tjetër, ambasadori Braathu shprehu gatishmërinë e tij dhe të misionit të OSBE-së për të bashkëpunuar dhe asistuar Ministrinë e Drejtësisë me çdo program mbështetjeje teknike për forcimin e kapaciteteve të këtij institucioni në reformat e ndërmarra.



# 28 masa të reja për parandalimin e pandemisë Covid-19



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

Prishtinë, 1 korrik - E drejtuar nga kryeministri Avdullah Hoti, Qeveria e Kosovës ka zhvilluar të mërkurën mbledhjen e rregullt në të cilën ka miratuar vendime nga fushat e saj të përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore. Po ashtu, një pikë tjetër e theksuar nga kryeministri Hoti ka qenë situata e re lidhur me pandeminë Covid-19. "Ne kemi pasur konsultime të ngushta me Ministrinë e Shëndetësisë dhe komitetin brenda ministrisë për këtë çështje. Janë duke u krijuar kapacitete shtesë në Klinikën Infektive dhe në klinikat e tjera dhe nëpër spitale regjionale për këtë çështje, por të gjithë duhet të jemi të përkushtuar dhe të disiplinuar për ta çuar mesazhin e nevojshëm te qytetarët e vendit sa i përket menaxhimit të kësaj pandemie. Trendi që kemi parë me rritjen e rasteve të të infektuarve është në përputhje me trendin që janë në regjion dhe më gjer, me kthimin e një vale të dytë të pandemisë, andaj ne jemi të shtrënguar që t'i marrim masat e nevojshme që ta menaxhojmë situatën në mënyrë adekuate", ka thënë kryeministri Hoti.

Me qëllim të parandalimit të infeksionit Covid-19, Qeveria e Kosovës ka miratuar kërkesën e Ministrisë se Shëndetësisë për ndërmarrjen e 28 masave të reja për parandalimin e këtij virusi:

1. Reduktimi i punonjësve në administratë vetëm në staf esencial dhe angazhimi i tyre me punë nga shtëpia (online), përgjysmimi i personave në secilën zyrë në përputhje me manualin;
2. Të mbyllen zyrat apo njësitë në të gjitha institucionet publike dhe biznese private ku ka raste pozitive;
3. Për personat me të cilin ka pasur kontakt personi tashmë i konfirmuar me Covid-19 pozitiv, zbatohen protokollet në fuqi;
4. Kontaktet duhet të vetizolohen për 14 ditë në shtëpi dhe nuk duhet të kenë asnjë kontakt gjatë kësaj periudhe;
5. Kontaktet këshillohen për monitorim të shëndetit për 14 ditë pas datës së fundit të ekspozimit dhe të kërkojnë kujdes të menjëhershëm shëndetësor nëse shfaqin ndonjë simptomë (ethe, temperaturë, kollitje, vështirësi në frymëmarrje ose diarre);
6. Të gjitha rastet pozitive dhe kontaktet e tyre mbikëqyren nga shtabet komunale, kontrollohen nga inspektorati, QKMF-ja dhe organet e rendit;
7. Në mënyrë rigoroze të respektohen masat mbrojtëse të vendosura nga IKShPK-ja;
8. Në mënyrë strikte të respektohet distanca fizike, përdorimi i maskave, dezinfektimi dhe ajrosja e lokaleve, duke pamundësuar përhapjen eventuale të infeksionit dhe shmangien e përhapjes në hapësirat e mbyllura;
9. Inspektoratet sanitare të AUV dhe inspektoratet komunale ta zbatojnë ligjin për Inspektoratin dhe Ligjin për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse dhe të merren masa në raste e moszbatimit eventual të rekomandimeve të IKShPK-së;
10. Punëtorët shëndetësorë t'u përmbahen rekomandimeve të IKShPK-së në përdorimin e masave mbrojtëse duke ruajtur kështu shëndetin e tyre, të pacientëve dhe të gjithë qytetarëve të vendit;
11. Bartja e maskave të jetë obligative;
12. Institucionet që ofrojnë shërbime përmes sporteleve janë të obliguara, si punonjësit ashtu edhe palët, të mbajnë maskë, të respektohet distanca prej 2 metrash në pritje në radhë, me mundësi të pritjes në hapësirat e jashtme sipas Manualit për luftimin e Covid-19;
13. Kontroll rigoroz i bartjes së maskave në hyrje të çdo institucioni;
14. Bartja e obliguar e maskës në transportin publik, taksive si të punonjësit ashtu edhe të udhëtarëve, të respektohet distanca prej dy metrash, ajrosja natyrale (hapja e dritareve) dhe dezinfektimi i automjeteve së paku dy herë gjatë ditës;
15. Ndërpriten aktivitetet në sektorin e identifikuar të institucioneve përkatëse të listuar sipas gjurmimit aktiv epidemiologjik;
16. Bartja e obligueshme e maskave nga organet e rendit (zyrtarët policorë);
17. Ndalimi i vizitave të familjarëve te pacientët në institucionet shëndetësore (lejohet vetëm një përcjellës sipas nevojës);
18. Reduktimi i operacioneve efektive në institucionet shëndetësore;
19. Bartja e obligueshme e pajisjeve personale mbrojtëse në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private brenda dhe jashtë institucioneve;
20. Kontroll rigoroz i inspektoratit shëndetësor në institucionet shëndetësore;
21. Ndalohet grumbullimi në hapësirat e mbyllura dhe të hapura për më shumë se 50 persona;
22. Kontroll i rreptë nga organet e inspektoratit dhe policisë për respektimin e distancës prej 2m dhe bartja e maskës në çdo hapësirë të mbyllur (zyra, qendra tregtare, sportele) dhe të hapura (gastronomia në tërësi);
23. Në veçanti veprimtaritë tregtare (maketet, furrat e bukës, barnatoret etj.) dhe gastronomia janë të obliguara të bartin maska dhe qasje të lehtë dhe të vazhdueshme në përdorimin e dezinfektuesve;
24. Ceremonitë mortore të zhvillohen vetëm me rrethin e ngushtë familjar;
25. Angazhohen organet përkatëse ta mbikëqyrin zbatimin e këtyre masave;
26. Ministria e Shëndetësisë dhe IKShPK-së do ta përcjellin gjendjen dhe, nëse rëndohet situata, atëherë do të kërkohet kthimi i masave rigoroze të rekomanduara sipas OBSh-së;
27. Komunat t'i aktivizojnë plotësisht shtabet lokale.
28. Zbatimi i masave shtesë të mbrojtjes për shtëpitë e pleqve.

## Apeli merr vendim kundër Grabovcit dhe të tjerëve

Prishtinë, 1 korrik - Departamenti Special i Gjykatës së Apelit në Prishtinë ka njoftuar të mërkurën se ka gjetur fajtorë të akuzuarit me inicialet A. G. dhe I. G. për dy vepra penale, "shkelje e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Kosovës", në përputhje me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

I akuzuari tjetër, S. G., është akuzuar për një vepër të tillë penale.

Të akuzuarit A. G. i është shqiptuar dënimi me kusht prej 1 vjet e 2 muajsh burgim. Dënime, po ashtu me kusht, kanë marrë edhe I. G., 1 vit e katër muaj burgim dhe S. G., 8 muaj burgim. Të tre të dënuarve u është ndaluar ushtrimi i funksioneve në administratën publike apo shërbimin publik për periudhë dyvjeçare.

Mediat lokale në Kosovë kanë raportuar se bëhet fjalë për ish-shefin e grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Adem Grabovcin, Ilhami Gashin, dhe Sadat Gashin, të cilët janë dënuar për rastin e njohur si "Pronto".

Më 3 janar të këtij viti Gjykata Themelore në Prishtinë pati



shpallur të pafajshëm Grabovcin për akuza që përfshinin edhe 10 persona me funksione të larta zyrtare, si ish-ministrin e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj dhe deputetin Zenun Pajaziti.

Në aktakuzë ishte trajtuar çështja penale e punësimeve dhe ndarjes së posteve të bazuara në përkatësinë partiake dhe raporte personale.

Ngritja e aktakuzës kishte pasuar me publikimin në media të bisedave telefonike të vitit 2011 të ish-shefit të grupit parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, në të cilat qenë përfshirë, veç të tjerash, edhe presidenti aktual Hashim Thaçi dhe ish- kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli. Në vendimin e 1 korrikut, Apeli ka thënë se aktgjykimi i Gjykatës Themelore është ndryshuar vetëm për pikën II dhe III të dispozitivit.



# Kryeministri dhe guvernatori bisedojnë për tërheqjen e kursimeve nga Trusti

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Kryeministri i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti dhe ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, kanë takuar të mërkurën guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe drejtuesit e Trustit, me të cilët kanë biseduar për ecurinë e procesit të implementimit të nismës së Qeverisë së Kosovës për t'ua krijuar qytetarëve mundësinë që t'i tërheqin 10 për qind të kursimeve të tyre nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, me qëllim të zbutjes së pasojave në ekonominë familjare pas krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19.
Me këtë rast, kryeministri Hoti ka kërkuar përshpejtimin e këtij procesi, duke theksuar se është shumë e rëndësishme që qytetarët ta kuptojnë se mundësia për ta tërhequr 10-përqindëshin e kursimeve të tyre nuk është politikë sociale, sepse për këtë ne si qeveri kemi pako të tjera, por është pjesë e vullnetit dhe e vendosmërisë sonë për t'u ndihmuar qytetarëve tanë në mënyrë që ata ta përballojnë sa më lehtë gjendjen e krijuar si pasojë e pandemisë Covid-19.
Ndërsa guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti dhe drejtuesit e Trustit, janë zotuar se do t'i shtojnë punët për ta lehtësuar këtë proces, duke u krijuar qytetarëve qasje më të lehtë në të dhënat e tyre dhe për shtjellimin e ecurisë së tërheqjes së mjeteve të tyre personale, pas ndryshimeve të nevojshme ligjore.

# Rrjeti i Shitësve me Pakicë: Shpresa e vetme mbetet funksionalizimi i pakos së rimëkëmbjes

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 KORRIK - Rrjeti i Shitësve me Pakicë, me qëllim të vlerësimit të ndikimit të pandemisë Covid-19 në sektorin e shitjes me pakicë, ka përfunduar një anketë me anëtarët që përfaqëson, rezultatet e së cilës kërkojnë vëmendje të shtuar nga ana e institucioneve qeverisëse dhe konsensus mes partive politike lidhur me Pakon e rimëkëmbjes ekonomike.
Bazuar në rezultatet e anketës, 80 për qind e bizneseve vlerësojnë se kanë pasur rënie domethënëse të të ardhurave. "Vendosja e masave kufizuese si dhe rënia e aktivitetit ekonomik si pasojë e gjendjes emergjente të shëndetit publik ka ndikuar në masë të madhe në operimet e bizneseve, gjersa një numër i konsiderueshëm i tyre edhe nuk janë lejuar ta ushtrojnë aktivitetin ekonomik. Në këtë drejtim, 60 për qind e bizneseve konsiderojnë se kjo situatë ka ndikuar shumë në ndryshimin apo ristrukturimin e objektivave të tyre strategjike, duke vënë theksin mbi nevojën e intervenimit të institucioneve qeverisëse me masa stimuluese ekonomike", thuhet në komunikatën e Rrjetit të Shitësve me Pakicë.
Sipas kësaj komunikate, rënia e fuqisë blerëse, likuiditeti i ulët dhe zbutja e besimit të konsumatorit përbëjnë sfidat më të rëndësishme që kanë ndikim direkt në të bërit biznes, gjersa situata me përhapjen e Covid-19 nuk duket optimiste. "Në këtë drejtim, 80 për qind e bizneseve konsiderojnë se do të ketë rënie të mëtutjeshme të konsumit pas pandemisë, duke sugjeruar kështu për një tronditje të madhe ekonomike.



Megjithatë, përkundër dëmtimit të theksuar të zinxhirit të furnizimit gjatë kësaj periudhe, çmimi i produkteve në treg ka mbetur i njëjtë, gjersa vështirësitë në furnizim vazhdojnë të mbeten problem për 20 për qind të bizneseve. Lidhur me tregun e punës, 60 për qind e bizneseve operuese në sektorin e shitjes me pakicë kanë bërë me dije se nga puna kanë larguar apo pauzuar më shumë se 50 punëtorë pas përhapjes së pandemisë Covid-19. Në anën tjetër, 40 për qind e bizneseve nuk kanë asnjë të punësuar të larguar apo pauzuar nga puna", thuhet në këtë komunikatë.
Marrë parasysh këto të dhëna, Rrjeti i Shitësve me Pakicë konsideron se situata e krijuar duhet të shërbejë si një klithmë për ndërhyrje sa më të shpejtë në ekonomi përmes një pako gjithëpërfshirëse stimuluese dhe se çdo vonesë në arritjen e konsensusit për Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike dëmton bizneset në themele. "Andaj, rrjeti ripërsërit shqetësimin e anëtarëve lidhur me diskursin politik dhe kërkon nga partitë politike të arrijnë konsensus për miratimin e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike", theksohet në komunikatën e Rrjetit të Shitësve me Pakicë.

## Kuçi merr pjesë në takimin e Ministrave të Ballkanit Perëndimor

PRISHTINË, 1 KORRIK (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka marrë pjesë të mërkurën në takimin e Ministrave të Ballkanit Perëndimor të fushës së TIK me temën "Ballkani Perëndimor për Epokën Digjitale" të organizuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe i realizuar në formë virtuale.
Ndikimi i Marrëveshjes së Roamingut Rajonal dhe hapat e ardhshëm në drejtim të regjionit pa tarifa të roamingut deri më 1 korrik 2021 ka qenë çështja e parë e trajtuar në këtë takim, ku Kuçi ka paraqitur të arriturat e palës së Kosovës për zbatimin e kësaj marrëveshje dhe ka shprehur gatishmërinë për përmbushjen e obligimeve të radhës drejt heqjes së plotë të tarifave të roamingut deri më 1 korrik 2021.
Çështje tjetër e trajtuar në këtë takim ministror ka qenë agjenda e transformimit digjital në Ballkanin Perëndimor përtej vitit 2020. Në këtë rast, Kuçi ka prezantuar planet dhe prioritetet e Kosovës për zhvillimin e sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), gjegjësisht të Agjendës Digjitale të Kosovës. Po ashtu, ai ka shprehur gatishmërinë e vendit tonë për implementimin e veprimeve në kuadër të fushave për ekonominë rajonale (REA 2021-2024) dhe vazhdimin e bashkëpunimit me të gjitha palët në rajon, që të arrihen të gjitha objektivat në mënyrë sa më efikase.



QEVERIA E KOSOVËS DHE PËRFAQËSUESIT E SINDIKATAVE JANË PAJTUAR QË TA FORMOJNË GRUPIN PUNUES PËR TA PROCEDUAR NË KUVEND LIGJIN PËR PAGA

# Hoti: Me urgjencë do t'i trajtojmë vërejtjet e Kushtetueses për Ligjin e Pagave



Kryeministri i vendit, Avdullah Hoti, ka pritur të mërkurën në takim përfaqësuesit e sindikatave të sektorit publik, një ditë pasi Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë Ligjin për Paga. Ai ka thënë se me urgjencë do t'i trajtojnë vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese. "Unë do të vazhdoj të komunikoj me sindikalistët. Do të jem afër me ta dhe do ta mbikëqyr nga afër punën e grupit punues që do ta përgatisë Ligjin për Paga për ta dërguar sa më parë në Kuvend", ka thënë Hoti

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 1 korrik - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka mbajtur të mërkurën një takim me përfaqësuesit e sindikatave të sektorit publik, një ditë pasi Gjykata Kushtetuese ka hedhur poshtë Ligjin për Paga. Pas këtij takimi, Hoti në një konferencë për media ka thënë se në koordinim me këto sindikata do ta bëjnë një ligj dhe do ta dërgojnë për procedim në Kuvend. "Në takime urgjente të organizuara me përfaqësues të sindikatave jemi pajtuar që qeveria menjëherë ta formojë grupin punues, për ta proceduar në Kuvend Ligjin për Paga, duke marrë parasysh argumentet e Gjykatës Kushtetuese dhe grupet e tjera që mund të kenë pasur vërejtje për këtë ligj. Unë do të vazhdoj të komunikoj me sindikalistët. Do të jem afër me ta dhe do ta mbikëqyr nga afër punën e grupit punues që do ta përgatis Ligjin për Paga për ta dërguar sa më parë në Kuvend", ka thënë Hoti.

Sipas kryeministrit Hoti, në grupin punues do të jenë të përfshira të gjitha këto sindikata, sepse ky ligj është për këta të punësuar që përfaqësohen nga kryetarët e sindikatave, ndërsa zotimi i qeverisë është që do të nisë menjëherë, brenda procedurave sa më të shkurtra të mundshme ligjore, për ta proceduar këtë ligj.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese për anulimin e Ligjit për Paga ka pasur reagime të shumta. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) e ka quajtur të papranueshëm këtë vendim të Kushtetueses. "Për Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës vendimi i Gjykatës Kushtetuese për anulimin e Ligjit për Paga, pa lënë hapësirë për korrigjimin e tij në ato pak pjesë kontestuese, është i papranueshëm. Ky është mohim i drejtës në përfitim nga puna për mbi 62 000 shërbyes civilë. Gjykata Kushtetuese ua ka humbur shpresat punëtorëve të Republikës së Kosovës të cilët me padurim e kanë pritur zbatimin e këtij ligji. Konsiderojmë se Gjykata Kushtetuese e ka ngacmuar plagën e hapur të punëtorëve dhe nëse kjo plagë nuk shërohet, do të ketë trazira sociale", thuhet në reagimin e BSPK-së.

Edhe ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka shprehur keqardhjen për shpalljen nga Gjykata Kushtetuese si i pavlefshëm Ligji për Paga në sektorin publik, me të cilin parashihej ngritja e pagave për profesionistët shëndetësorë të sektorit publik shëndetësor në Republikën e Kosovës. Ai ka theksuar se shpallja e këtij ligji i pavlefshëm, ndonëse kundërshtimet lidheshin më shumë me sektorët e tjerë, përbën një lajm jo të mirë dhe dekurajues për profesionistët shëndetësorë. "Ne e kuptojmë këtë edhe sikur ata të mos e shprehin vetë. Megjithatë, me gjithë mirëkuptimin e plotë ndaj zhgënjimit që mund ta kenë profesionistët shëndetësorë me epilogun e këtij ligji, si institucione dhe shoqëri jemi të obliguara që t'i zbatojmë vendimet e institucioneve tona shtetërore, në këtë rast vendimin e Gjykatës Kushtetuese", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka shtuar se "kjo nuk nënkupton që me këtë aktka përfunduar çdo gjë rreth angazhimeve për përmirësimin e pozitës materiale të profesionistëve shëndetësorë, sepse Ministria e Shëndetësisë do ta ndërmarrë hapa në drejtim të zhvillimit të një dialogu të drejtpërdrejtë me odat e profesionistëve shëndetësorë, sindikatat dhe mekanizmat e tjerë, me qëllim që ta gjejmë rrugën më të mirë dhe më adekuate për t'i shtyrë para dhe mbrojtur interesat e profesioneve mjekësore".

Zemaj ka theksuar se pandemia dhe puna që personeli shëndetësor kanë treguar gjatë kësaj kohe është një argument më shumë për t'i bindur edhe të tjerët se është e domosdoshme që nismat ligjore për përmirësimin e statusit social të punonjësve shëndetësorë janë të domosdoshme. Ai ka bërë me dije se do të angazhohet që në bashkëpunim me qeverinë të shohin cila do të jetë alternativa më e mirë që punonjësve shëndetësorë t'u respektohen të drejtat e tyre dhe të trajtohen me dinjitet brenda shoqërisë sonë.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shpallur të pavlefshëm Ligjin për Paga në Sektorin Publik. Sipas vendimit, ligji nuk është në përputhshmëri me 11 nene të Kushtetutës së Kosovës. Ligjin për Paga më 6 dhjetor të vitit të kaluar në Gjykatën Kushtetuese e ka dërguar institucioni i Avokatit të Popullit për, siç thuhet, "vlerësimin e përputhshmërisë" së këtij ligji me Kushtetutën. Kurse Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës kishte vendosur që të pezullohet zbatimi i këtij ligji deri më 30 mars 2020.

Ligji për Paga është miratuar në muajin shkurt të vitit 2019, kurse në fillim të muajit mars patë hyrë në fuqi. Sipas ligjit të ri, paga bazë është ajo pjesë e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë të një funksioni apo pozite të caktuar. Vlera e pagës bazë llogaritet duke shumëzuar koeficientin e klasës së pagës me vlerën monetare të koeficientit. Raporti i koeficienteve është një me dhjetë (1:10), të shpërndarë në gjashtëdhjetë e nëntë (69) nivele të koeficienteve. Koeficienti më i lartë është 10, pozitë kjo që e mban vetëm presidenti i Republikës së Kosovës, më pas është niveli 9, ku bëjnë pjesë kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe kryetari i Gjykatës Kushtetuese i Republikës së Kosovës.

Ligji për Paga rregullon rritjen e pagave për 70 për qind të punëtorëve në sektorin publik, kurse 30 për qind mbeten jashtë. Por, punonjës në sektorë të ndryshëm publikë kishin shprehur pakënaqësitë lidhur me përcaktimet dhe përfshirjen e tyre në ligj.

# Haziri: Rasti i ndarjes nga jeta i Isuf Muratit, dhimbje për të gjithë dhe thirrje për kujdes

GJILAN, 1 KORRIK (ER) - Komuna e Gjilanit, në ditën e 111 të ballafaqimit me pandeminë globale Covid-19, ka marrë lajmin e hidhur nga Klinika Infektive në Prishtinë dhe nga familja, se ka ndërruar jetë Isuf Murati, i lindur në vitin 1957, me vendbanim në Gjilan.
Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka konfirmuar rastin e vdekjes së qytetarit të katërt nga kjo sëmundje infektive dhe i ka shprehur ngushëllime familjes, duke e garantuar se gjithmonë do të jenë pranë tyre. “Fatkeqësisht, në përballjen me pandeminë globale Covid-19 sot nga jeta është ndarë edhe qytetari i Gjilanit, i katërti në këtë pandemi, Isuf Murati. Nga njoftimi që kemi marrë prej Qendrës Klinike Infektive në Prishtinë, sot ishte një lajm i vështirë për të gjithë ne. Ngushëllojmë familjen dhe garantojmë se do të jemi pranë saj në këto ditë të vështira sepse nuk e ka të lehtë ballafaqimin me këtë ndarje nga më i dashuri i tyre. Ceremonia e varrimit do të organizohet nga Komuna e Gjilanit në kushte pandemie”, ka thënë kryetari Haziri në adresimin e tij për publikun.
Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve, bizneseve dhe institucioneve që në asnjë çast mos ta neglizhojnë këtë virus sepse ai me vete po merr jetë njerëzish.
Deri më tani, në përballjen prej 111 ditëve me pandeminë globale Covid-19, 170 qytetarë kanë rezultuar pozitiv në Komunën e Gjilanit, prej tyre 109 janë shëruar plotësisht, 58 raste janë aktive dhe katër qytetarë janë ndarë nga jeta.



# Në laboratorin e QKMF-së në Podujevë kryhen testet për Covid-19

PODUJEVË, 1 KORRIK (ER) - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e së mërkurës është informuar për gjendjen e sigurisë në komunë si dhe për gjendjen e krijuar nga pandemia Covid-19 dhe ka shqyrtuar çështje të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë e qytetarëve.
Lidhur me gjendjen e sigurisë në Komunën e Podujevës, komandanti i Stacionit Policor në Podujevë, kapiteni Bekim Zogiani, ka thënë se gjendja e përgjithshme e sigurisë është e mirë dhe se situata gjatë pandemisë me Covid-19 është duke u menaxhuar mirë falë bashkëpunimit me të gjitha organet dhe institucionet komunale.




Gjendjen e sigurisë e kanë vlerësuar të mirë edhe përfaqësuesit e KFOR-it dhe të FSK-së. Përfaqësuesi i KFOR-it ka lavdëruar punën e mirë të Policisë së Kosovës dhe institucioneve shëndetësore.
Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zaim Thaçi, duke raportuar për gjendjen aktuale me pandeminë Covid-19, ka thënë se që nga paraqitja e rasteve të para deri më tani në Komunën e Podujevës janë kryer mbi 300 teste për Covid-19, prej të cilave kanë rezultuar pozitivë 48 persona, prej tyre 23 janë shëruar, kurse një person ka ndërruar jetë.
Drejtori Thaçi ka pohuar se në të gjitha rastet që kanë rezultuar pozitivë, ekipi emergjent bashkë me policinë i ka vizituar familjet, ku është kryer kontrolli mjekësor dhe është bërë dezinfektimi i objekteve të banimit.
Më tej, ai ka thënë se ekipi emergjent i asistencës sociale është përkujdesur që të sigurojë pako ushqimore dhe higjienike për familjet e prekura me Covid-19.
Ndërkaq nënkryetari i Komunës së Podujevës, Nexhmi Rudari, ka thënë se lajm i mirë për qytetarët e kësaj komune është se prej të mërkurës më nuk do të kenë nevojë të shkojnë në Prishtinë për kryerjen e testeve për Covid-19, pasi për të gjitha rastet e dyshuara mostrat e testit do të merren në laboratorin e QKMF-së në Podujevë.
Rudari, duke falënderuar qytetarët për bashkëpunimin e treguar në menaxhimin e deritashëm të situatës me Covid-19, u ka bërë thirrje t'i zbatojnë rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të IKShPK-së për aplikimin e masave mbrojtëse, të përfshira edhe në manualin për mbrojtje nga ky virus.

## Malisheva ndalon hyrjet në objektin e QKMF-së pa maska mbrojtëse

MALISHEVË, 1 KORRIK (ER) - Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon Hoti, ka bërë me dije se pacientët të cilët vizitojnë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Malishevë dhe në qendrat e tjera mjekësore nuk do t'u lejohet hyrja në objektet shëndetësore pa maskë mbrojtëse. “Të gjithë pacientët që kanë nevojë të vizitohen në qendrat mjekësore, si në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, ashtu edhe në qendrat e tjera, janë të obliguar të mbajnë maska mbrojtëse. Përdorimi i maskave mbrojtëse dhe masave të tjera është obligim, pasi ende jemi në situatë emergjente shëndetësore për shkak



të pandemisë Covid-19. Mbajtja e maskave mbrojtëse është obliguese prandaj, ju lutemi të gjithëve, mbani maska dhe ruani shëndetin tuaj dhe të të tjerëve”, ka thënë Hoti.

## Nis fushata e korrje-shirjeve në Suharekë

SUHAREKË, 1 KORRIK (ER) - Ka filluar fushata e korrje-shirjeve në Komunën e Suharekës, ndërsa rendimentet e para të grurit, sipas informacioneve nga terreni, janë të kënaqshme.
Drejtori i Bujqësisë në këtë komunë, Xhevxhet Gashi, ka bërë me dije se kokrrat e para të grurit janë shirë në fshatin Studençan dhe në Gjinoc. “Këtë vit do të angazhohen rreth 55 autokombajna. Ndërsa një lajm i mirë është gatishmëria e pronarit të autokombajnës, Skënder Hyseni, i cili me rastin e nënshkrimit të kontratës, ka bërë zbritje prej pesë eurosh në çdo hektar të korrur për shkak të gjendjes së krijuar nga pan-



demia”, ka njoftuar Komuna e Suharekës.
Ndërsa kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, i ka uruar bujqit që të kenë rezultate më të mira të punës së tyre.

# KOSOVA NË UDHËKRYQ. A DO TË ARRIJNË LIDERËT INSTITUCIONALË DHE POLITIKË T'IA DALIN?



Shkruan: Ramiz KELMENDI

Pamfleti nga Gjykata e Hagës e ndaloi, preu përkohësisht, një marrëveshje ndërkombëtare jetike për të ardhmen e shtetit të Kosovës, një marrëveshje e cila do ndodhte nga ajo Shtëpi e Bardhë që urdhëroi forcat e NATO-s ta bombardonin Serbinë në vitin 1999.
Hapja e paraprocedurës në këtë kohë, hapja e paraprocedurës për kreun e UÇK-së, për kreun e PDK-së, dy personalitetet e rëndësishme të jetës politike dhe institucionale të shtetndërtimit, hapja e paraprocedurës për presidentin e vendit, janë jashtëzakonisht të dëmshme, nëse bëhen të plotfuqishme, sepse akuzat janë të rënda, të pavërteta, të nxitura nga Dick Marty dhe duhet kohë për t'u vërtetuar.
Andaj, si të tilla, këto akuza vendosin njollë të përkohshme edhe te miqtë ndërkombëtarë. Duhet cekur se këto akuza kanë rrjedhur si një lumë nëntokësor kohë më parë. Këto akuza kanë mobilizuar edhe vetë këta liderë të akuzuar që të iniciojnë dhe mbështesin nismën për formimin e Gjykatës së Hagës dhe të gjitha këto zhvillime mbi tokë janë bërë në vazhdimësi dhe janë mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare.
Po e kthej në vëmendje ish-zëvendëspresidentin amerikan Biden, i cili presidentin Thaçi e quajti Xhorxh Uashingtoni i Kosovës. Kujtojmë këtu edhe të gjitha ato bashkëpunime dhe bashkëveprime me bashkësinë ndërkombëtare nga z. Kadri Veseli si në aspektin politik dhe në forma të tjera të bashkëpunimit të sigurimeve nga agjencitë inteligjente të huaja, të izoluara dhe të pamundësuara t'i rrënojnë arritjet politike dhe ekonomike të vendit.
Shtrohet pyetja, çka ndodhi dhe si ndodhi kaq shpejt? Kjo duhet të jetë sprovë për ta parë spektrin politik si do të veprojë me agjendë shtetërore, a do të orientohet agjenda në përpjekje të brendshme apo do të unifikohen dhe t'i tregojnë bashkësisë ndërkombëtare se akuzat janë akuza të institucioneve juridike të formuara dhe mbështetura po nga këta liderë dhe nga shumë të tjerë që mund të jenë të përfshirë në akuzimet e ardhshme.
Dorëheqja duhet dhe është e papranueshme, sepse për t'i përmbyllur proceset politike të vendit, është e paevitueshme pjesëmarrja e presidentit të vendit dhe mbështetja e liderëve politikë, në veçanti nga lideri i Vetëvendosjes, si lider nga partia më e madhe dhe e mbështetur nga PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja, Nisma dhe AKR-ja, por edhe e qeverisë, meqë përvoja politike e z. Thaçi është e domosdoshme përkundër politikanëve të pabesë serbë në krye me Vuçiqin i cili mori mbështetje të madhe nga qytetarët e vet.
Andaj, uniteti dhe mbështetja e spektrit politik në vendin tonë duhet pranuar me urtësi dhe me përulje e dinjitet, por edhe mbështetja e këtyre liderëve po bëhet në emër të besimit, se UÇK-ja dhe udhëheqësit e tyre janë të pastër dhe në emër të besimit se çdo gjë po bëhet dhe po ndodhë për të ardhmen e Kosovës.
Sot më shumë se kurrë na duhet unitet i shprehur, i cili do të gjejë mundësi që të shkohet në Shtëpinë e Bardhë pa dëmtuar zgjedhjet presidenciale, në veçanti të z. Trump.
Pa unitet të qartë të liderëve politikë, pa mbështetje qytetare të gjithëmbarshme që do të krijojë opinion edhe te BE-ja, se çështjet juridike dhe ato shtetërore janë të ndara dhe në momentin që fuqizohen, do të respektohen siç ishte edhe në të kaluarën kur z. Haradinaj në dy raste u tërhoq nga pozitat e larta shtetërore, ne e kemi vështirë t'ia dalim. Le ta kujtojmë si liderë politikë dhe si qytetarë gjenocidin e hapur mbi Srebrenicën, gjenocidin e Milloshevqit mbi shqiptarët në tërësi, e i cili vdiq dhe nuk u dënua për veprën e gjenocidit, rastësi apo veprim për ta ndarë nga jeta, kjo i mbetet historisë.
Por shqetësuese për globin le të mbetet se edhe sot, pas vdekjes së tij, disa qarqe në Serbi ende i qëndrojnë besnik dhe duke heshtur. Andaj, është e imja dhe besoj shumë njerëzisht, të kërkoj nga liderët politikë ta mbështesin luftën e pastër të UÇK-së dhe udhëheqësve të saj, ta mbështesin institucionin e presidentit dhe t'u tregojnë miqve amerikanë dhe evropianë (BE-së), se në bisedimet me Serbinë dhe arritjen e marrëveshjes do ta vazhdojnë me unitetin tonë, me liderë institucionalë Thaçi - Hoti dhe ekipet e tyre, sepse këta liderë institucionalë gëzojnë mbështetjen dhe kanë aftësinë për të bërë marrëveshje të qëndrueshme dhe të pranueshme. Në të kundërtën, vala pandemike që po zgjatë do të ndikojë në stabilitet ekonomik dhe politik, i cili mund të rezultojë në prolongimin e çështjes sonë në pafundësi, sikurse Palestina.

# Bahtiri nënshkroi kontratat për bursa me 52 studentë

Mitrovicë, 1 korrik (ER) - Në sallën e Kuvendit Komunal të Mitrovicës, kryetari Agim Bahtiri, ka nënshkruar kontratat për bursa me 52 studentë për vitin akademik 2019/2020. Me rastin e nënshkrimit të kontratave ishin të pranishëm edhe nënkryetari Faruk Mujka dhe drejtoresha e Administratës, Valmire Sylejmani.
Në fjalën e tij para studentëve, Bahtiri ka thënë se ndihet krenar që kanë përfituar bursa të gjithë studentët të cilët kanë plotësuar kriteret dhe se kjo mbështetje financiare do t'ua lehtësojë sadopak obligimet familjarëve të tyre në mënyrë që studentët të fokusohen në aspektin e studimeve drejt realizimit të qëllimeve dhe aspiratave të tyre. "Është kënaqësi e veçantë që jam sot në mesin tuaj dhe unë çdoherë do të jem mbështetës i njerëzve të cilët e duan vendin e tyre. Këtë jeni duke e dëshmuar me suksesin tuaj, pasi që keni arritur të jeni përfitues të bursave komunale dhe jeni studentë të dalluar, jeni ardhmëria e qytetit tonë dhe sigurisht, përpos ngritjes profesionale, nesër edhe ndonjëri prej jush do të jetë në pozita udhëheqëse si në aspektin e nivelit lokal, po ashtu edhe në atë qendror, në fushat e ndryshme. Andaj ju inkurajoj që të mësoni e studioni për ta ngritur diturinë tuaj që në të ardhmen të bëheni profesionistë të vërtetë", ka thënë Bahtiri.
Pas nënshkrimit të kontratave, studentët janë shprehur të jenë të kënaqur me ndarjen e këtyre bursave. Disa nga ata janë shprehur të jenë mirënjohës për mbështetjen që komuna po ua ofron si një motiv shtesë për t'i vazhduar studimet dhe një lehtësim financiar për familjet e tyre.



## Austria vendos masa të udhëtimit ndaj banorëve të Ballkanit Perëndimor



VJENË, 1 KORRIK - Austria ka lëshuar paralajmërime udhëtimi për vendet e Ballkanit për shkak të një rritje të numrit të të infektuarve me Covid-19 atje, ka thënë ministri i Jashtëm i Austrisë, Alexander Schallenberg.
Banorëve të Kosovës, Shqipërisë, Malit të Zi, Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Bosnje e Hercegovinës, u kërkohet që të vetizolohen për 14 ditë, me të hyrë në Austri, ose duhet të tregojnë një test negativ të Covid-19.
Masa e Austrisë është një goditje e veçantë për Serbinë dhe Malin e Zi, vende këto të cilat Bashkimi Evropian të martën i shtoi në "listën e sigurt" të vendeve, duke lejuar udhëtimin e banorëve të tyre në BE. "Ne po reagojmë në bazë të rrethanave, jo vetëm situatës në ato vende, por edhe faktit që ne shohim, për shembull në vendet tona fqinje Kroaci dhe Slloveni, një rritje në grupimet e njerëzve që kthehen nga udhëtimi në Ballkanin Perëndimor", ka pohuar Schallenberg në një konferencë për media. Ai ka shtuar se tubime të tilla janë vërejtur edhe në Austri.
Numri i të infektuarve është rritur ndjeshëm gjatë muajit të kaluar në Ballkanin Perëndimor, megjithëse rajoni në përgjithësi ka pasur norma më të ulëta se shumica e Evropës perëndimore.

# Kriza e pandemisë, prioriteti kryesor i presidencës gjermane të BE-së




BERLIN, 1 KORRIK - Më 1 korrik Gjermania ka marrë përsipër presidencën gjashtëmujore të Bashkimit Evropian. Shumë vende anëtare të BE-së e presin me padurim fillimin e presidencës gjermane të Bashkimit Evropian, të udhëhequr nga Angela Merkel, e cila insiston në ruajtjen e tregut evropian, integritetin politik dhe, mbi të gjitha, solidaritetin në një kohë krize shëndetësore dhe ekonomike, por edhe populizmin dhe euroskepticizmin në rritje.
Kancelarja gjermane Angela Merkel ka thënë se tejkalimi i pandemisë së koronavirusit është një përparësi kryesore për presidencën e BE-së. Merkeli tashmë ka përgatitur një plan të rimëkëmbjes ekonomike për ta ndihmuar BE-në të përballet me pasojat pandemisë së koronavirusit.
Më 29 qershor Merkeli priti presidentin francez Emmanuel Macron, pasi të dy udhëheqësit mbështesin bashkërisht fondin e rimëkëmbjes së BE-së. Merkeli tha se Gjermania dhe Franca në muajt e ardhshëm duan të luajnë një rol së bashku duke e bërë të qartë se Evropa është e ardhmja jonë.
Ajo ka theksuar unitetin gjermano-francez në rindërtimin e ekonomisë së BE-së, duke pranuar se "pritjet janë të larta" pasi Gjermania ta marrë presidencën e radhës së BE-së.
Merkeli dhe Macron së bashku propozuan krijimin e një fondi 500 miliardë dollarësh për ta ndihmuar Evropën të dalë nga dëmi i rëndë ekonomik i shkaktuar nga pandemia e koronavirusit.
Një test i parë i madh për presidencën gjermane do të jetë një samit i BE-së më 17 dhe 18 korrik, ku Merkeli shpreson se liderët do të arrijnë një marrëveshje mbi fondin.
Presidenti Macron përsëriti qëndrimin e tij se një marrëveshje mbi buxhetin e BE-së dhe fondin e rimëkëmbjes mund të gjendej në samitin e korrikut. Ai tha se fondi duhet të përfshijë 500 miliardë euro grante për vendet më të goditura. Propozimi i përbashkët u zgjerua nga Komisioni Evropian, i cili parashtroi plane për një fond prej 750 miliardë eurosh.
Paratë pritet t'i ndihmojnë vendet më të goditura nga pandemia, të tilla si Italia e ngarkuar me borxhe dhe Spanja. Megjithatë disa vende anëtare e kanë kundërshtuar planin.
Austria dhe Holanda po insistojnë që për vendet të ndahen hua dhe jo grante. "Fondi nuk mund të zgjidhë të gjitha problemet e Evropës, por pa të gjërat vetëm do të përkeqësohen", ka deklaruar Merkeli në një intervistë të publikuar më 26 qershor.
Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, u ka bërë thirrje vendeve anëtare që ta japin dritën jeshile për një paketë të madhe stimuluese deri në fund të korrikut.
Gazeta "Financial Times" shkruan se gatishmëria e Gjermanisë, për ta zgjidhur çështjen e fondit të rimëkëmbjes, në muajin korrik ka një shpjegim të thjeshtë. Agjenda e presidencës së saj do të bëhet gjithnjë e më e zënë pas pushimeve të verës, pasi diskutimet për një marrëveshje të ardhshme tregtare midis BE-së dhe Mbretërisë së Bashkuar do të shtohen.
Berlini, gjithashtu, dëshiron një debat mbi të ardhmen e Bashkimit Evropian në gjysmën e dytë të vitit 2020.
Në një fjalim para parlamentit gjerman, javën e kaluar, Merkeli tha se nuk është vetëm çështje e kapërcimit të krizës aktuale të pandemisë, por "çfarë do ta bëjë Evropën më efikase në të ardhmen". Pandemia, tha ajo, zbuloi "sa i brishtë është projekti evropian". Gjermania, shtoi Merkeli, duhet ta përdorë presidencën e saj për të promovuar programe për mjedisin dhe ato digjitale.
Berlini, gjithashtu, dëshiron t'i vazhdojë bisedimet për reformimin e sistemit të migracionit të BE-së si dhe ta fillojë diskutimin se si BE-ja mund të marrë më shumë përgjegjësi në botë, thekson "Financial Times", duke shtuar se Gjermania do të organizojë një samit të Bashkimit Evropian dhe Unionit Afrikan në muajin tetor.
Ndërkaq, gazeta britanike "The Guardian", në një artikull të saj shkruan se Merkeli beson se solidariteti është i domosdoshëm në Evropë. "Ajo me të vërtetë paralajmëroi se dështimi në veprimet e përbashkëta të stabilizimit të ekonomisë në Evropë do t'u shkonte për shtati forcave antidemokratike dhe autoritare. Në një kohë kur aksionet nuk kanë qenë kurrë më të larta, presidenca gjermane e BE-së, e udhëhequr nga Angela Merkel, është një lajm i mirë për BE-në", ka shkruar "The Guardian".

## Erdogani paralajmëron masa të ashpra ndaj mediave sociale

Ankara, 1 korrik - Turqia do të përgatisë një projektligj për t'i kontrolluar platformat e mediave sociale ose për t'i mbyllur ato. Kështu ka bërë me dije presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan. Ai ka thënë se familja e tij ishte fyer në internet. "Ministri i Financave, Berat Albayrak, dhëndri i Erdoganit, ka njoftuar përmes një postimi në rrjetin social 'Twitter' se kishte lindur fëmija i tij i katërt. Gruaja e Albayrak, Esra, ishte fyer nga disa përdorues të cilët u arrestuan më vonë", ka deklaruar ministri i Brendshëm turk, Suleyman Soylu.
Presidenti Erdogan ka thënë se Partia për Drejtësi dhe Zhvillim do të paraqesë një projektligj për ta kontrolluar përdorimin e mediave sociale, duke shtuar se një rritje e "akteve imorale" vitet e fundit është pasojë e mungesës së rregullave. "Këto platforma nuk i përshtaten këtij kombi. Ne duam t'i mbyllim, t'i kontrollojmë ato duke sjellë një projektligj në parlament sa më shpejt të jetë e mundur", ka thënë ai.
Erdogani ka pohuar se kompanitë e mediave sociale do të detyroheshin të emëronin përfaqësues në Turqi, për t'iu përgjigjur kërkesave ligjore, për të cilat ai tha se aktualisht janë injoruar.
Në muajin qershor Turqia kritikoi ashpër kompaninë "Twitter" për pezullimin e më shumë se 7 000 llogarive që mbështesnin presidentin



Erdogan, duke thënë se kompania po njollos qeverinë dhe po përpiqet ta ridizajnonte politikën turke.

# SI U DHA ÇMIMI I PARË NOBEL PËR LETËRSINË?

Nga: Gunnar AHLSTROM

Pas shumë hezitimesh, diskutimesh, zvarritjesh dhe pikëpyetjesh edhe pa përgjigje, Akademia suedeze, i jep më 1901 dhe për herë të parë Çmimin Nobel të Letërsisë, Sully Prudhomme-s, anëtar i Akademisë franceze.

Vendimi u bë publik në Stokholm, më 10 dhjetor 1901. Ja si shkruan një nga gazetat suedeze: "Pra nuk zgjidhet as Tolstoi, as Ibsen, as Bjôrnson, as Mommsen, as Swinburne, as Zola, as Anatole France, as Carducci, as Mistral, as Hauptmann as edhe Echegaray, por zgjidhet Sully Prudhomme".

Ky konstatim, me negativitet si dhe me hamendjet e tij, fsheh një debat të gjatë në vazhdim. Ai shfaq një farë situate të brendshme të vendit i cili jep Çmimin, dhe po ashtu ndriçon në një farë mënyre, situatën letrare në vendin e fituesit. Duke parë se Franca ishte zgjedhur vendi, i cili dukej që do të priste dhënien e Çmimit, brezat e ardhshëm mund të pyesin se përse nuk iu dha Zolës apo Anatol France-t. Kritika letrare foli për një gjuhë ndryshe të përdorur nga personalitetet e kohës. Çmimi Nobel, ishte një terren i veçantë, i mbjellë nga një tokë akademike, me mendimtarë të rëndësishëm brez pas brezi, me njohuri të rrënjosura nga një ideal thelbësor. Për shumë vite me radhë, fjala "ideal" diku e rrezikshme, duhej patjetër të luante një rol tepër të rëndësishëm në diskutimet relative për dhënien e Çmimit, duke u peshuar mirë në zgjedhjen e kandidatëve fitues.

Në vitin 1900 u hap biblioteka e cila do të ndiqte zhvillim e literaturës botërore, dhe mes anëtarëve të Akademisë, u krijua një Komitet special i ngarkuar të punonte për përgatitjen e dhënies së çmimit. Thembra e Akilit ishte Sekretari i Përgjithshëm i Akademisë, Dr. Carl David af Wirsén. Si poet ai ishte tepër kërkues, katolik dhe po aq paqësor. Si kritik i letërsisë moderne, kishte një karakter luftarak. Mbështetur në rregulloren e vendosur për dhënien e çmimit, të gjitha aktet e kandidaturave duhet t'i nënshtroheshin kontrollit të Akademisë suedeze nga Akademia franceze, spanjolle dhe suedeze; sekretarët e burimeve njerëzore të Akademive të tjera; anëtarë të institucioneve dhe shoqatave të ngjashme me Akademinë, nga profesorë të universiteteve, mësues të estetikës, të letërsisë dhe historisë. Propozimet duhet t'i paraqiteshin Akademisë para 1 shkurtit 1901. Rrjeta u hodh në gjithë Evropën dijetare.

U prit me muaj të kapej peshku i gjetur. Hap pas hapi filluan të vijnë përgjigjet nga njëri vend në tjetrin. Ato filluan të analizohen nën fshehtësinë më të madhe. Kërshëria rritej dhe kjo për arsye që kuptoheshin. Bëhej fjalë për një shumë të konsiderueshme të hollash në jetën letrare. "Shkrimtarët e huaj për herë të parë, fillojnë të shohin larg, drejt Akademisë në Stokholm", shkruante një figurë e shquar suedeze. Tani, pas kaq vitesh, kur mund të zbulojmë sekretin e fshehur prej kohësh nëpër dokumentet e vjetra, jemi të lumtur të ndjekim çdo etapë mbështetur në ato që dëshmohen. Bëhej fjalë për një anketë internacionale, të paparë ndonjëherë, dhe konstatohet me kënaqësi që Akademia e vogël e mjekrave të bardha (të vjetra) kaq herë e kritikuar, po shfaqej plotësisht në lartësinë e duhur për misionin e saj të vështirë e fisnik. Të gjitha përgjigjet e ardhura nga vendet e ndryshme me fletoren zyrtare, ishin regjistruar me kujdes sipas rendit alfabetik të dërguesve për t'u shpërndarë më pas të rikopjuara, tek gjithë anëtarët e Akademisë, në përgjithësi dhe Komitetit Nobel në veçanti.

Në krah të Sekretarit të Përgjithshëm me shpirt luftarak, ndodhej një profesor i historisë tepër i njohur në gjuhën romane, po ashtu në letërsi; gjuhëtar i shquar i gjuhëve skandinave herë pasardhës e herë homonim i Esaias Tégner, "mjekra klasike" e Suedisë, i vetmi poet cilësor, Konti Carl Snoilsky, drejtor i Bibliotekës mbretërore të Stokholmit.

Britania e madhe, ky vend ishullor, gjithmonë i rezervuar, paraqitet një njollë e bardhë në hartë. Asnjë propozim, asnjë emër i shënuar. Polonia prezantohet hijshëm me Henry Sienkiewicz-in kandidatura e të cilit mbrohej me inteligjencë nga dy historianë të njohur suedez. Gjermania një vend me kokën pas nga impulset energjike të Guillaume II, kërkon t'i dëgjohet zëri në një dokument (plein d'emphase). Një profe-




sor në Dresden rekomandon me forcë që të merret në konsideratë një këngëtar pothuajse i panjohur, për "talentin e tij lirik tepër të madh".

Gjuhëtari roman, me në krye profesorin e vjetër të Ienas, W.Cloetta, e kthejnë kokën nga bregu i Rinit dhe i Ronit duke tërhequr vëmendjen tek një poet provincial, Frédéric Mistral. Përballë këtyre veprimeve të shpërndara, shpesh me kërshëri, siguria e rutinës bie në përgjigjet e herëpashershme të Francës, vend nga i cili prej shumë kohësh, jemi mësuar të marrim të veçanta akademike të rekomanduara. I madhi Marcelin Berthelot nuk ka nevojë për shumë fjalë në prezantimin e kandidaturës së Emil Zola-s. I zgjedhur në Akademinë franceze më 1900, në cilësinë e anëtarit, propozon një shkrimtar të frymëzuar nga shkencat natyrale dhe liberalizmi demokratik. Edmond Rostand nuk ka nevojë as ai për elozhe të shumta : u propozua nga Paul Hervieu në garancinë e Cyrano de Bergerac dhe Aiglon. Gjithçka është shprehur qartë dhe në mënyrë të përmbledhur.

Larg hapësirave të Parnasse-t, pak i njohur si jashtë si edhe në Suedi, bëhej fjalë për René Vallery-Radoti-n, cili u bë shkak i një veprimi të bashkërenduar në favor të biografisë së vjehrrit të tij "Jeta e një Pastori". Duke qenë se ishte nipi i Eugène Sue dhe Emile Legouvé-t, bashkëpunëtori i parë i Buloz-it tek "Revue des deux Monde"», (Revista e dy Botëve) ai ishte familjarizuar me suksesete e letërsisë. Nuk do të gabohej supozimi që prania e tij mes nobelistëve rezulton si goditje e fortë alarmi. Të gjithë shfaqën mendimin se "Jeta e një Pastori" është një vepër letrare e jashtëzakonshme në kuptimin e idealizmit.

Zhurma e kësaj fushate kishte mbërritur deri në Paris dhe u hapi rrugën manifestimeve të pakënaqësisë nga ana e Kolegjit të Francës ku Paul Meyer rekomandon Mistral, me një shënim anësor: "Vallery-Radot propozuar nga Vogué, është një arritje…". Një rrëmujë e tillë nuk kishte gjë tjetër për qëllim, veçse të shpërqendronte vëmendjen e Komitetit.

Sully Prudhomme hyn mes kandidaturave të nobelistëve nga një tekst tepër i rëndësishëm datuar më 10 janar 1901 dhe firmosur nga Gaston Paris, Gréard, Paul Bourget, Gaston Boissier, André Theuriet, Henry Houssaye, François Coppée, Ludovic Halévy, Henri de Bornier, José-Maria de Hérédia, Jules Lemaitre, C.de Freycinet e Emille Deschanel. Tekst aprovohet po ashtu edhe nga Emile Olivier, Costa de Beauregard e Emile Faguet. Ky manifestim masiv i natyrës gjysmë zyrtare, eklipsoi në votimin e shpërndarë shteteve të tjera si Italia, Greqia, Norvegjia madje dhe vetë Suedia ku Gaston Paris ishte rekomanduar nga një kolegët e tij adhurues, në Universitetin e Upsalas.

Me gjithë këto ndërhyrje të gjata, zgjedhja nuk ishte dhe aq e vështirë, ku pas marrjes së vendimit përfundimtar nga Akademia në një seancë plenare më 14 nëntor, Sully Prudhome, u lajmërua se çmimi i ishte akorduar "në mirënjohje të meritave të veçanta që ai ka treguar si autor deri në vitet e fundit, dhe në veçanti për poezinë e tij e cila dëshmon një idealizëm të arrirë, në një përsosmëri artistike dhe me një ndërthurje kaq të rrallë të cilësive të shpirtit dhe të gjeniut". Që në 19 nëntor mbërriti një letër me një përgjigje tepër elegante ardhur nga Châtenay, vendi ku ai banonte. "Ndiej krenari të pakufishme dhe lumturohem duke menduar nderin e një instance kaq të lartë dhe kërkuar nga shumë shkrimtarë të tjerë më lartë se unë, kjo fitore i shkon atdheu tim, të cilit i detyrohem për këtë nderim e vlerësim të veprës sime". Dhe duke qenë se këtu nuk bëhet fjalë vetëm për fitore, por edhe 208.950 franga, fituesi jep me kënaqësi të dhënat e llogarisë së bankës në Paris. Publiku nuk ishte ende në dijeni dhe fituesit i ishte lutur, të mbante fshehtësinë, derisa të behej dorëzimi zyrtar i çmimit më 10 dhjetor, datë e vdekjes së Alfred Nobel. Dihej mirë që profesor Roentgen, ndodhej në Grand Hotel, dhe prania e tij kuptohej, ishte e justifikuar për Çmimin në Fizikë. Vetëm të ftuarit e dinin që ambientet për letërsinë nuk do të ziheshin. Që në fillim, Sully Prudhomme, kishte deklaruar se për arsye të një sëmundjeje të gjatë, nuk mund të paraqitej. Kjo në fakt i prishte pak planet e organizimit. Prania e tij nën uniformë, natyrisht që do të bënte efektin e vetë të veçantë gjatë ceremonisë.

Jetohej në atë epokë ku zinin vend fjalët e mëdha me frazat e gjata, të cilat përmbanin një amalgamë kuptimesh nga një anë ezoterike dhe po aq dehëse. Çmimi i akorduar Sully Prudhomme në emër të tij dhe në emër të atdheut, u tërhoq nga Ministri Francës, zoti Marchand, ku "veshja e thjeshtë dhe demokratike", sipas komenteve të shtypit, "as një kordon në kostumin e tij të zi", nuk bënte kontrast para shkëlqimit të gjelbër suedez. Por çfarë mendonte vetë Sully Prudhomme i tërhequr në Francë? Disa ditë më vonë i intervistuar nga një gazetar i "Le Figaro", ai shfaqej i gëzuar dhe i çuditur për çmimin që i ra si nga qielli, po ashtu dhe shuma pothuajse e njëjtë me ato që kishte fituar nga poezitë e tij, në këto tridhjetë e pesë vjet.

"Mendoj kolegët e mi të rinj, të cilët nuk kanë mundësinë të botojnë poezitë në fillimet e tyre. Kam dëshirën që një pjesë t'ua fal atyre që nuk munden të botojnë librin e tyre të parë me poezi. Deri tani kam marrë një lumë kërkesash, shuma e të cilëve e kalon krejt Çmimin". Sully Prudhomme nuk ishte i pari që u çudit. E papritura nuk ishte po aq e vogël edhe në Suedi, ku çmimi i tij provokoi një reaksion të veçantë. **/TCh/**

E jashtëzakonshme

# Në Jerusalem zbulohet një vulë antike e periudhës persiane



Arkeologët izraelitë kanë zbuluar një vulë në Jerusalem, që ka të ngjarë të datojë nga shekulli VI para Krishtit, ka njoftuar Autoriteti Izraelit i Antikiteteve (IAA). Arkeologët besojnë se gjetjet datojnë nga periudha persiane në Jerusalem, pas shkatërrimit të qytetit nga babilonasit. “Pavarësisht prej gërmimeve të shumta të kryera në Jerusalem, deri tani gjetjet e zbuluara nga periudha persiane janë jashtëzakonisht të pakta dhe për këtë arsye na mungon informacioni në lidhje me karakterin dhe pamjen e qytetit gjatë asaj periudhe”, njoftuan studiuesit Yuval Gadot dhe Yiftah Shalev në një deklaratë të përbashkët.

## BARSOLETA E DITËS



Një polic ndalon një djalë të ri dhe i vë gjobë për ecje me shpejtësi.
Djali: Vërtet shpejt po ecja?
Polici: Jo, po fluturoje ngadalë.

**Në Kino ABC nuk ka shfaqje**

## FOTO E DITES



Pamje e bukur nga gryka e Rugovës në Pejë

# Arbenita provokuese para pasqyrës

Njëra nga modelet që po merr vëmendje të vazhdueshme nga fansat është padyshim Arbenita Ismajli.
Ajo pothuajse në shumicën e kohës komentohet për bukurinë dhe linjave trupore, që shpesh i ekspozon para kamerës.
Një gjë të tillë e ka bërë edhe kohët e fundit përmes një postimi në rrjetin social Instagram, në të cilën është shfaqur tërheqëse.
E veshur më një fustan të bardhë, Arbenita ka marrë poza të ndryshme para pasqyrës, ndërsa në plan të parë ka vënë gjoksin.
Në imazhin e tretë, ajo ka është parë me një dukje goxha të thjeshtë, duke përdorur makijazh në mënyrë minimale.



E rrallë

# Turistë nga Austria, me traktorë për pushime në Mal të Zi



Të gjithë ata që duken si turistë këto ditë po tërheqin vëmendjen në Mal të Zi. E gjithë kjo po ndodh për shkak të koronavirusit që ka kapluar mbarë botën Sidoqoftë, siç raporton “Radio Jadran”, në vendkalimin kufitar “Debeli Brijeg”, ku ka pothuajse dhjetë herë më pak pasagjerë se vitin e kaluar, ata kaluan kufirin me traktorë të modifikuar, të cilëve iu bashkëngjitën rimorkiot. Duket se austriakët me këto mjete kampingu të pazakonshme synojnë të udhëtojnë nëpër Mal të Zi. Austria gjendet në të ashtuquajturën listën e gjelbër në mesin e vendeve që lejohen të futen në shtetin respektiv.



**DASHI** Ky muaj do të nisë në mënyrë mjaft interesante, veçanërisht sa iu takon projekteve të reja lidhur me punën.



**DEMI** Do të nisë për ju një javë mjaft pozitive, sidomos pasi Venusi do të ketë ndikim të favorshëm në shenjën tuaj.



**BINJAKËT** Do të jeni të mbushur me energji dhe gjithë grintë gjatë kësaj fillim jave. Do të nisë për ju një verë e mbarë. Ditë të mira janë në horizont.



**GAFORRJA** Do të ndiheni shumë i motivuar gjatë kësaj dite. Megjithatë, përballë një projekti të ri do të keni frikë se mos gaboni.



**LUANI** Kjo javë do të jetë mjaft e rëndësishme për ju. Do të keni mundësi që të dilni në pah dhe të vini në dukje gjërat për të cilat jeni të zotët.



**VIRGJËRESHA** Do të jetoni një fillim jave aspak në ritmin e duhur. Do të ndiheni mjaft konfuz, edhe pse në raportin në çift keni përjetuar shumë tensione.



**PESHORJA** Dita e parë e muajit do t’ju gjejë të dekurajuar. Në sferën profesionale do të keni ndjesinë e ecjes në zbrazëti.



**AKREPI** Do të nisë për ju një javë mjaft e rëndësishme, sidomos sa iu takon situatave të mjegullta.



**SHIGJETARI** Kjo e mërkurë nuk do të jetë aspak ideale, ku mund të ndiheni disi i turbullt. Mos u dekurajoni.



**BRICJAPI** Ky muaj do të nisë i mbushur me dyshime sa iu takon raporteve me të tjerët. Nëse kohët e fundit keni përjetuar një krizë në dashuri, gjatë këtyre ditëve mund të kthehen tensionet.



**UJORI** Do të nisë për ju një fazë mjaft konfuze. Megjithatë duhet të qartësoheni me veten, edhe për të kuptuar se çfarë dëshironi realisht.



**PESHQIT** Mund të përballeni me pasojat e disa veprimeve tuaja. Shpesh ju ndodh që ta gjeni veten të përfshirë në situata negative.

# Dua Lipa, bashkëpunim me Madonën



Dua Lipa dëshiron të bëjë një bashkëpunim me Madonën, e këtë e ka konfirmuar edhe menaxheri i këngëtares shqiptare Ben Mawson. Në një intervistë për "Music Week", teksa ka folur për albumin e fundit të yllit muzikor "Future Nostalgia", ai ka shtuar se ishte ndikuar shumë nga "Confessions on a Dancefloor" nga Madonna, e se të dy përmbajnë këngë të prodhuara nga Stuart Price. I pyetur nëse Dua Lipa mund të jetë Madonna e ardhshme, Mawson u përgjigj: "Varet çfarë nënkuptoni me këtë. Dua padyshim do të ketë një karrierë të gjatë. Ajo është një yll i kompletuar i muzikës pop dhe albumi është influencuar dukshëm nga Madonna. Në fakt, ne po përpiqemi të kontaktojmë me Madonën për një bashkëpunim. Do t'i dërgoj një e-mail e do të shohim nëse do të pranojë".



# Vajza e Beyonce dhe Jay-Z fiton Bet Awards në moshën 8-vjeçare

Në moshën 8-vjeçare vajza e madhe e Beyonce dhe Jay-Z ka marrë një çmim në Bet Awards për zërin e saj në këngën "Brown Skin Girl", duke u bërë kështu fituesja më e re e të gjitha kohëve. Kënga është e mamit Beyonce, e reperit amerikan Saint Jhn dhe e këngëtari nigerian Wizkid është pjesë e albumit "The Lion King: The Gift" (kolona muzikore e filmit 'Mbreti luan').

# Për ku është nisur Era Istrefi?



Era Istrefi është shfaqur tepër seksi në disa fotografi të cilat i ka postuar në rrjetet sociale. Këngëtarja ka qenë e qetë gjatë gjithë pandemisë, derisa ishte shfaqur vetëm një herë me disa fotografi që i kishte bërë gjatë ditëlindjes së vajzës së motrës së saj, Nora Istrefit. Por, ajo ka postuar disa fotografi ku shihet në një avion derisa poshtë tyre ka shkruar: "Po shkoj diku". Këngëtarja pas këngës "Bonbon" nuk ka pasur suksese të mëdha derisa disa këngë të saj kanë pasur sukses të kufizuar dhe jo atë që është pritur në fillimet e




këngëtares pasi ka nënshkruar kontratën me "Sony Entertainment".

# U nda nga e dashura, Ryan Seacrest pushime me një tjetër



Ryan Seacrest dhe Shayna Taylor i kanë dhënë fund për herë të tretë lidhjes së tyre gjashtëvjeçare pas ndarjeve dhe pajtimeve të njëpasnjëshme. Lajmin e ka konfirmuar për "E!News" një burim i afërt i prezantuesit të njohur amerikan. "Ryan dhe Shayna vendosën t'i jepnin fund romancës së tyre para pak kohësh. Ata janë ende miq dhe mbështetësit më të mëdhenj të njëri-tjetrit", citon burimi. Gazetari 45-vjeçar nuk ka pritur shumë gjatë. Pas ndarjes me modeluesen 28-vjeçare, ai është fotografuar duke pushuar me një vajzë misterioze në Meksikë. Sipas burimeve për "E!News", Ryan udhëtoi fundjavën e kaluar për në Cabo San Lucas me avion privat me disa miq, ku pjesën më të madhe të kohës e kaloi me një bionde.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Dukagjini, ende pa rënë, mendon për rikthimin në Superligë

KF Dukagjini, ende pa përfunduar ky kampionat në Superligë, ka filluar të mendojë se si të rikthehet pas një viti sërish në këtë rang elitar. "Tash kemi një përvojë në Superligë dhe do të punojmë me përkushtim që pas një viti të rikthehemi sërish", ka thënë Fabian Veseli, drejtor i Dukagjinit

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 1 korrik** - Skuadrës së Dukagjinit nga Klina i kanë mbetur edhe gjashtë ndeshje për të zhvilluar në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, pasi ky klub në edicionin e ri do të bëjë gara në Ligën e Parë. "Aventura" në rangun më të lartë të garave duket si i ka pëlqyer shumë këtij klubi që ka filluar të mendojë për rikthimin në elitë pas një viti.



Drejtori i Dukagjinit, Fabian Veseli, ka thënë se nuk janë të kënaqur me përformacën e treguar në Superligë, ani pse klubi nga Klina qëllim kryesor e kishte rikthimin në këtë rang të garave. Ai në një bisedë për "Epokën e re" ka thënë se Dukagjini do të paraditet në mënyrën më të mirë që të jetë pjesë e Ligës së Parë vetëm për një edicion. "Nuk jemi të kënaqur me rezultatet e arritura në Superligë, por rëndësi kishte që në të inkuadrohemi në këtë rang garash për faktin se ishin ishte bërë një kohë e gjatë që nuk ia kishim arritur këtij qëllimi. Renditja në fund të tabelës tregon qartë se Superliga kërkon shumë më shumë se Liga e Parë. Tash kemi një përvojë në Superligë dhe do të punojmë me përkushtim që pas një viti të rikthehemi sërish", ka thënë Veseli.

Në skuadrën e Dukagjinit luajnë futbollistë me emër si Milicaj, Merlaku, Elezaj, Muhaxheri, Dushi, Lloga, Demiri e shumë të tjerë. Drejtori Veseli ka konfirmuar se shumica nga këta lojtarë do të luajnë për Dukagjinin edhe në Ligën e Parë. "Duke parë se kemi synime të mëdha në Ligën e Parë, atëherë mund të them se nëntëdhjetë për qind e këtyre futbollistëve nuk do të largohen", ka deklaruar ai.

Dukagjini në 27 ndeshjet e zhvilluar ka mbledhur vetëm dhjetë pikë, kurse ka regjistruar vetëm dy fitore dhe katër barazime, kurse në 21 ndeshjet e tjera ka pësuar humbje. Trepça '89 dhe Vushtrria janë dy skuadrat e vetme që kanë pësuar humbje nga Dukagjini.

# Komisioni Shëndetësor i FFK-së: Zyrtarët e klubeve nuk po i respektojnë masat mbrojtëse

**Prishtinë, 1 korrik** - Komisioni Shëndetësor i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) ka reaguar se nuk po respektohet plotësisht udhëzuesi i masave mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, i përpiluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik për rifillimin e IPKO Superligës.




"Masat mbrojtëse janë duke u monitoruar nga zyrtarët shëndetësorë të Federatës së Futbollit të Kosovës në të gjitha ndeshjet. Zyrtarët e të gjitha klubeve të IPKO Superligës (pa përjashtim), që po qëndrojnë në tribuna gjatë ndeshjeve, nuk po i respektojnë masat mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19. Kurse lojtarët, stafi i trajnerëve dhe ekipet mjekësore kryesisht janë duke i respektuar masat mbrojtëse", thuhet në reagimin e Komisionit Shëndetësor. Zyrtarët shëndetësorë të Federatës së Futbollit të Kosovës kërkojnë nga të gjithë zyrtarët e klubeve të IPKO Superligës, që gjatë pranisë së tyre në tribuna të mbajnë maskë dhe ta mbajnë distancën nga njëri-tjetri.

## SHKURT

### Shotani: Drejtimin e Drenicës mund ta marr vetëm në fillim të kampionatit

Skuadra e Drenicës ka mbetur pa trajner për gjashtë ndeshjet e fundit të këtij kampionati, pasi ditë më parë është larguar nga kjo detyrë Gani Sejdiu. "Shqiponjat e Zeza" tashmë në duelin e së premtes pritet të drejtohen nga ndihmësi i Sejdiut, Brahim Vojvoda. "Olle" e ka kontaktuar ish-trajner-in e njohur që më parë ka drejtuar Drenicën, Bekim Shotani. Ky i fundit ka mohuar kontaktet me klubin kuqezi, derisa ka thënë se nuk është i gatshëm për ta marrë drejtimin e kësaj skuadre. "Kontakte me Drenicën kam pasur në dhjetor të vitit 2019, por që nuk kishte diçka konkrete. Unë në Drenicë kam qenë më parë dhe kemi kaluar një sezon shumë të suksesshëm, por aktualisht nuk jam kontaktuar nga ta", ka thënë Shotani. "Gjithsesi, Drenicën mund ta udhëhoqi vetëm nga fillimi i sezonit të ri dhe jo tani në fund, kur kanë mbetur vetëm 6 ndeshje", ka shtuar Shotani.

### Fenerbahçe e kishte refuzuar Tottenhamin për Muriqin

"Channel A Sport" raporton se Fenerbahçe e ka refuzuar një ofertë të Tottenham Hotspurit për Vedat Muriqi në afatin kalimtar të janarit. Raportohet se "Spursi" kishte ofruar 19 milionë euro për Muriqin, por klubi turk e refuzoi këtë ofertë pasi synonte ta shiste reprezentuesin e Kosovës 28 milionë euro. Interesim për Muriqin kanë shfaqur edhe West Bromi, Manchester United, Southamptoni dhe Leicester City.

### Zabergja largohet nga KEK-u

Sulmuesi Enis Zabergja është larguar nga skuadra e KEK-ut. Lajmin e ka konfirmuar vetë sulmuesi me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës. "Ju njoftoj se më nuk do të jam pjesë e klubit FC KEK-u. Falënderoj klubin për korrektësinë, bashkëlojtarët dhe presidentin dhe ju uroj çdo të mirë", ka thënë Zabergja, i cili ka luajtur për shumë klube në Kosovë: Llapin, Hajvalinë, Drenicën, Trepçën dhe Hysin.

### Edhe 6 basketbollistë të NBA-s infektohen me Covid-19

Shtohen rastet me Covid-19 në NBA. Në 24 orët e fundit konfirmon 6 raste të reja me koronavirus. Tre raste i përkasin ekipit të Neë Orleansit dhe tri ekipit të Denverit. Presidenti i New Orleansit, David Grifn, tha se tre lojtarë kanë dalë pozitivë, por nuk ka bërë me dije emrat e tyre. Ai thënë vetëm se basketbollistët janë në izolim, ku do të qëndrojnë për 15 ditë dhe do t'u nënshtrohen testeve të tjera. E njëjta situatë edhe te Denveri, ku nuk dihen emrat e 3 basketbollistëve që kanë dalë pozitivë me Covid-19, por vetëm që ata janë në karantinë. Kjo rritje e ndjeshme e rasteve me koronavirus mes lojtarëve ka rikthyer frikën se turneu mund të mos rinisë. Kampionati i NBA-së është ndalur që në mars dhe pritet të rinisë më 30 korrik, në Orlando, ku do të marrin pjesë 22 ekipe.

## Zidane: Nuk do të pushojmë derisa të shpallemi kampionë



MADRID, 1 KORRIK - Trajneri i Real Madridit, Zinedine Zidane, ka thënë se skuadra e tij nuk do të pushojë derisa të shpallet kampion në La liga. Barcelona barazoi me Atletico Madridin (2-2) dhe tani Reali ka mundësinë ta shtojë diferencën në katër pikë. "Janë ende 18 pikë të mbetura në lojë dhe nuk mund të themi asgjë derisa të shpallemi kampionë matematikisht. Unë kam qenë më parë në këtë situatë si lojtar dhe e di se nuk kemi fituar ende asgjë. Nuk do të pushojmë derisa të shpallemi kampionë", ka thënë Zidane.
Trajneri i Realit foli edhe për yllin e skuadrës, Eden Hazard. "Eden ka pasur pak vështirësi të përshtatej edhe për shkak se ka qenë jashtë fushave për një kohë të gjatë, por po kthehet shumë i fortë", ka deklaruar Hazardi.

# Mehmeti: Liga Kosovë - Shqipëri do ta zgjonte interesimin e publikut në të dyja vendet

PRISHTINË, 1 KORRIK - Formimi i Ligës Kosovë - Shqipëri po përkrahet nga komuniteti i basketbollit në Kosovë. Ideja po shihet si shumë e mirë, pasi do të kishte interesim të madh në dy vendet, derisa do të kishte rivalitet në fushë dhe zhvillim të basketbollit në dy shtetet.
Ish-basketbollisti i njohur, Artan Mehmeti, ka thënë se formimi i kësaj lige është një ide e qëlluar. "Mendoj se ideja është shumë e mirë, duke marrë parasysh se skuadrat tona këtë vit nuk do të luajnë në Evropë dhe interesimi i publikut do të jetë i madh. Mendoj se Shqipëria do të përfitonte shumë, sidomos me interesimin e publikut. Ndërkohë, sa i përket cilësisë, mendoj se skuadrat janë të përafërta në këtë ligë. Skuadrat duhet të jenë të organizuara mirë, duke llogaritur edhe shpenzimet e udhëtimit. Si përfundim, mendoj se ideja është shumë e mirë. Të shpresojmë për një vit më ndryshe, cilësor dhe jo monoton", ka thënë Mehmeti për faqen zyrtare të FBK-së.



Në Ligën Kosovë - Shqipëri do të garonin katër skuadra nga Kosova dhe katër nga Shqipëria. Për këtë Ligë është e njoftuar edhe FIBA Evropa, që nuk e ka kundërshtuar këtë ide.

# Tare: Lazio është i interesuar për Kumbullën



ROMË, 1 KORRIK - Marash Kumbulla mbetet në qendër të vëmendjes ashtu sikurse edhe Sergej Milinkovic-Savic. Shumë fjalë rreth mesfushorit serb, por Igli Tare, drejtori sportiv i Lazio, për "Sky Sport" ka deklaruar se në klubin e tyre nuk ka mbërritur asnjë ofertë. PSG-ja ka qenë klubi më i lakuar, ndërkohë që mesfushori për momentin po heziton të rinovojë. Në këto kushte italianët do të duhet të mendohen mirë dhe për ofertën e duhur normalisht se do ta shisnin. Ajo ditë ende nuk ka ardhur. Lazio momentalisht po punon edhe për të bërë përforcime dhe Marash Kumbulla është një prej objektivave. Për herë të parë Igli Tare ka folur për mbrojtësin e kombëtares shqiptare. "Futbollisti në fjalë na intereson. Kjo është arsyeja pse nuk u takuam me drejtuesit e Hellas Veronës. Është një profil që mund të jetë i rëndësishëm për vitet e ardhme. Gjithsesi ka ende bisedime që duhen bërë. Ne ishim të sigurt që nuk do ta mbyllnim dot të enjten", ka thënë Tare.

## SHKURT

### Ferrari ndryshon makinën para fillimit të sezonit

Ferrari është detyruar ta bëjë një ridizajnim të madh të makinës si rezultat i të metave të zbuluara qëkur u zhvillua në testimin e para-sezonit në shkurt. Bosi i ekipit Mattia Binotto tha se puna për të kuptuar pse makina ishte pa ritëm çoi në një "ndryshim të rëndësishëm të drejtimit në kuadër të zhvillimit". Makina me specifikat e tjera do të testohet këtë fundjavë, por nuk do të zhvillohet gara me të në Çmimin e Madh të Austrisë. Debutimi i makinës së ndryshuar pritet të ndodhë në Çmimin e Madh të Hungarisë më 17-19 korrik. Binotto ka thënë se ekipi ishte detyruar ta rishikojë qasjen e tyre ndaj aerodinamikës së makinës pas hetimit të tyre për mungesën e performancës së saj.

### Mkhitaryani vazhdon qëndrimin te Roma

AS Roma ka arritur marrëveshje me Arsenalin për zgjatjen e huazimit të Henrik Mkhitaryan. Mesfushori armen do të qëndrojë te verdhekuqtë deri në përfundim të këtij sezoni futbollistik, por me shumë gjasë do të jetë pjesë e Romës edhe në sezonin e ardhshëm pasi, siç njofton vetë klubi kryeqytetas, është arritur një marrëveshje paraprake që Mkhitaryan të qëndrojë te verdhekuqtë edhe në sezonin ardhshëm. "Jam shumë i kënaqur dhe i lumtur që e zgjas qëndrimin këtu. Kam ende gjëra që nuk i kam arritur dhe dua t'i arrij. Mezi pres të vazhdoj të luaj", ka thënë Mkhitaryan.

### Bayerni transferon talentin Kouassi

Pasi u shpallën kampionë për herë të 30 në Bundesliga, Bayern Muncheni ka nisur punën për ta ndërtuar ekipin e së ardhmes pjesë e së cilës do të jetë edhe Tanguy Kouassi. Bayerni ka bërë një të ofertë të madhe pasi bëhet fjalë për një nga talentet më premtues në Evropë, një lojtar që kërkohej edhe nga shumë klube të tjera. 18-vjeçari ishte pjesë e Paris Saint-Germainit në edicionin e fundit dhe ka regjistruar gjashtë paraqitje dhe i ka shënuar dy gola.

### Busquets: E kemi të vështirë mbrojtjen e titullit në La Liga

Mesfushori Sergio Busquets ka thënë se mbrojtja e titullit do të jetë një mision shumë i vështirë për skuadrën e Barcelonës, pasi ky klub ka luajtur baras në ndeshjen e fundit me Atleticon (2-2). "Të luftosh për titull është me të vërtetë e komplikuar kur i humb nga dy pikë në çdo ndeshje. Por, ne do të luftojmë deri në fund. Ne e dimë se është e vështirë, por do të tentojmë. Ata janë një rival i vështirë. Ne dominuam dhe krijuam raste, mirëpo u penalizuam nga dy penalltitë - është një turp i vërtetë", ka thënë Busquets. "Ne ishim liderë dhe ishim në pozitë të mirë para ndërprerjes së sezonit. Mendoj se ka qenë e vështirë për ne që nga atëherë. Në disa ndeshje kemi luajtur më mirë, në disa jo. Të humbasim pikë edhe sot e edhe në fundjavë bën që të jemi më larg qëllimit tonë, që është ta mbrojmë titullin e kampionit", ka shtuar Busquets.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

## SHPALLJE E REKRUTIMIT

01Nr.104/02-4274/20

